



Koha

www.koha.mk



Arti, zanat që nuk përfundon asnjëherë!

FAQE 12-13

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3138 • E enjte 3 gusht 2017 15 DEN

Çështje ditësh kur shqipja të vijë në Parlament



Shkup, 2 gusht - Ligji për përdorimin e gjuhëve të komuniteteve jo shumicë, apo i ashtuquajtur "ligji për shqipen", mund të aprovohet si propozim-ligj shumë shpejtë në Qeveri, ndërsa mund të vijë për miratim në Parlament para datës 8 gusht, kur dhe deputetët do të fillojnë pushimet vjetore.

Kështu për gazetën KOHA tha zëdhënës i Qeverisë së Maqedonisë, Mile Boshnjakovski, megjithëse se kur do të shkojë në Komisionin e Venedikut, ai tha se kjo do të dihet pasi të veprojë njëherë Qeveria. "Në mbledhjen e fundit u vendos që të punohet të drejtim të Agjencisë për përdorimin e gjuhëve dhe Inspektoratit për përdorimin e gjuhëve. Pasi të kompletohet propozim-ligji në lidhje me ato kompetenca, sipas informatave që kam, do të jetë në rend ditë në mbledhjen e radhës të Qeverisë pasi rreth kësaj çështje po punohet me dinamikë të theksuar..."

dorimin e gjuhëve dhe Inspektoratit për përdorimin e gjuhëve. Pasi të kompletohet propozim-ligji në lidhje me ato kompetenca, sipas informatave që kam, do të jetë në rend ditë në mbledhjen e radhës të Qeverisë pasi rreth kësaj çështje po punohet me dinamikë të theksuar...

Faqe 2

Maqedoni, 180 vetura në 1000 banorë

Çdo i pesti me veturë



Nga shtetet e rajonit, Maqedonia me 180 në 1000 banorë ka më shumë vetura vetëm se Kosova dhe Shqipëria që kanë afër 150 vetura në 1000 banorë, ndërsa ka më pak vetura se të gjitha shtetet në Ballkanin Perëndimor

FAQE 4

Ardhmëria e Ballkanit është në Perëndim



Podgoricë, 2 gusht - Ardhmëria e Ballkanit Perëndimor është në Perëndim, deklaroi sot në Podgoricë nënpresidenti amerikan Majk Pens dhe paralajmëroi se do të punojë në lidhjen midis BE-së, Ballkanit dhe SHBA-së. Pens në konferencën e përbashkët për shtyp me kryeministrin malazez Dushko Markoviç deklaroi se vi-

zita e tij në Mal të Zi e konfirmon mbështetjen e SHBA-së në rajon. "Hyrja e Malit të Zi në NATO është sukses historik dhe e tregon fuqinë e këtij vendi vetëm dhjetë vite pas ripërtëritjes së pavarësisë. NATO përbëhet nga shtete të mëdha dhe të vogla, por SHBA-ja nuk ka aleatë të vegjël dhe ne e vlerësojmë aleancën

tonë të re në NATO", theksoi Pens. Ai tha edhe se ardhmëria e rajonit është në Perëndim. "Besoj se ardhmëria e Ballkanit Perëndimor është në Perëndim dhe gëzohem që do të punojmë për përfundim të lidhjes midis BE-së, Ballkanit dhe SHBA-së. SHBA-të mbeten të përkushtuara në Ballkanin Perëndimor..."

FAQE 2

GLOBALI

Martese para myftiut



Që pas futjes në përdorim të Kodit Civil në vitin 1926, martesat në Turqi mund të lidhen vetëm përpara nëpunësit të gjendjes civile. Certifikata zyrtare e martesës ishte po ashtu kusht për lidhjen e martesës në xhami apo në një institucion tjetër fetar. Çiftet që nuk marthoheshin në gjendjen civile, por vetëm përpara...

FAQE 15

RAJON

Miratohet nisma për Kosovën në INTERPOL

FAQE 15

GLOBALI

"Vizita e shekullit", një mesazh adresuar Moskës

FAQE 15

FORUM

Pa njohje nuk mund të ketë normalizim



FAQE 10



Në pyetjen e gazetës KOHA nëse ligji mund të vijë për miratim në Parlament para datës 8 gusht, kur deputetët do të fillojnë pushimet - zëdhënësi Boshnjakovski tha se "është mëse e mundur të ndodhë, pasi ligji është gati përveç atyre harmonizimeve që ceka me lart". Ai mohoi të ketë ka mospajtime mes partnerëve qeverisës për ligjin e shqipes

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 2 gusht - Ligji për përdorimin e gjuhëve të komuniteteve jo shumicë, apo i ashtuquajtur "ligji për shqipen", mund të aprovohet si propozim-ligj shumë shpejtë në Qeveri, ndërsa mund të vijë për miratim në Parlament para datës 8 gusht, kur dhe deputetët do të fillojnë pushimet vjetore. Kështu për gazetën KOHA tha zëdhënësi i Qeverisë së Maqedonisë, Mile Boshnjakovski, megjithëse se kur do të shkojë në Komisionin e Venedikut, ai tha se kjo do të dihet pasi të veprojë njëherë Qeveria.

"Në mbledhjen e fundit u vendos që të punohet të drejtim të Agjencisë për përdorimin e gjuhëve dhe Inspektoratit për përdorimin e gjuhëve. Pasi të kompletohet propozim-ligji në lidhje me ato kompe-

Sipas informatave zyrtare nga Qeveria e Maqedonisë

Çështje ditësh kur shqipja të vijë në Parlament



tenca, sipas informatave që kam, do të jetë në rend ditë në mbledhjen e radhës të Qeverisë pasi rreth kësaj çështje po punohet me dinamikë të theksuar në Qeveri nga ministritë përkatëse", deklaroi Boshnjakovski. Në pyetjen tonë nëse ligji mund të vijë për miratim në Parlament para datës 8 gusht kur deputetët do të fillojnë pushimet, Boshnjakovski

tha se "është më se e mundur të ndodhë, pasi ligji është gati përveç atyre harmonizimeve që ceka me lart". Zëdhënësi Boshnjakovski përjashtoi çdo mundësi që, për ligjin në fjalë - ka mospajtime mes partnerëve qeverisës. "Absolutisht nuk kemi problem mes vete për ligjin në fjalë - për realizimin dhe zbatimin e së cilit e kemi vullnetin e plotë të vetë

kryeministrit Zoran Zaev", tha Boshnjakovski. Në lidhje me ligjin për gjuhën shqipe, LSDM ishte afër të prolongojë atë pas zgjedhjeve lokale që të mos i japë rast VMRO-së të thotë se kjo parti po u jep shumë të drejta shqiptarëve, ndërsa VMRO për shumë vite sa ishte në pushtet - nuk bëri hapa drejt avancimit të gjuhës shqipe. Për këtë qëndrim

enkas për gazetën KOHA në kushte anonimiteti foli njëri ndër pesat zyrtarët më të lartë partiak të LSDM-së që dolën nga Kongresi i fundit zgjedhor. Por nga na tjetër, BDI kërcënoi me votëbesim të Qeverisë, ndërsa Aleanca për Shqiptarët me braktisje të Qeverisë nëse ligji për gjuhën shqipe nuk do të miratohet brenda njëqind ditëshit të parë të

qeverisë. Kjo bëri që kryeministri Zaev pas dy muajve heshtje, pasi mori pushtetin, të deklarohet hapur se ligji për gjuhën shqipe do të miratohet para zgjedhjeve lokale, por se do të hyjë në fuqi pasi të jap mendim Komisioni i Venedikut nëse draft-propozimi i këtij ligji është në pajtim me Kushtetutën. Por kjo, nga shumë analistë dhe ekspertë kushtetues u quajt absurde meqë të gjitha nenet e propozuara të ligjit për gjuhën shqipe janë në pajtim me nenin 7 të Kushtetutës së Maqedonisë, i cili thotë se gjuhë zyrtare - përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, është edhe gjuha dhe alfabeti i saj që flitet nga mbi 20 për qind e popullatës joshumicë. Ndryshe, në draft-ligjin për të cilin janë marrë vesh LSDM me BDI-në dhe Aleancën për Shqiptarët parashihet përdorimi gjerë i gjuhës shqipe në Qeveri. Kur seancat udhëhiqen nga funksionarë shqiptarë dhe kur ministri është shqiptarë - ai ka të drejtë të flet në gjuhën shqipe. Mes tjerash, edhe të gjitha aktet juridike të qeverisë do të shpallen edhe në gjuhën shqipe. Jo vetëm në Qeveri, por edhe ne organet tjera shtetërore qoftë të pavarura apo qoftë të varura nga Qeveria, kur kryesuesi i mbledhjes është shqiptar, ai ka të drejtë të udhëheq në gjuhën shqipe, ndërsa çdo

Samiti i vendeve nga Karta e Adriatikut në Mal të Zi

Ardhmëria e Ballkanit është në Perëndim

"Fuqishëm besojmë se ardhmëria e Ballkanit Perëndimor është në Perëndim. Andaj edhe sot do të bisedojmë për forcimin e lidhjes mes Bashkimit Evropian, Ballkanit Perëndimor dhe SHBA-ve", shtoi Pence. Kryeministri malazez Markoviç tha se dita e sotme është tregues se në "bashkësinë ndërkombëtare nuk ekzistojnë të mëdhenj dhe të vegjël kur është fjala për përkatësinë e idealeve"



Podgoricë, 2 gusht - Ardhmëria e Ballkanit Perëndimor është në Perëndim, deklaroi sot në Podgoricë nënpresidenti amerikan Majk Pens dhe paralajmëroi se do të punojë në lidhjen midis BE-së, Ballkanit dhe SHBA-së. Pens në konferencën e përbashkët për shtyp me kryeministrin malazez Dushko Markoviç deklaroi se vizita e tij në

Mal të Zi e konfirmon mbështetjen e SHBA-së në rajon. "Hyryja e Malit të Zi në NATO është sukses historik dhe e tregon fuqinë e këtij vendi vetëm dhjetë vite pas ripërtëritjes së pavarësisë. NATO përbëhet nga shtete të mëdha dhe të vogla, por SHBA-ja nuk ka aleatë të vegjël dhe ne e vlerësojmë aleancën tonë të re në NATO", theksoi Pens. Ai tha edhe se ardhmëria e rajonit është në Perëndim. "Besoj se ardhmëria e Ballkanit Perëndimor është në Perëndim dhe gëzohem që do të punojmë për përfortim të forcimit të lidhjes midis BE-së, Ballkanit dhe SHBA-së. SHBA-të mbeten të përkushtuara në Ballka-

nin Perëndimor duke shfaqur shpresën se në Samitin e sotëm të shëfave të qeverive të vendeve të rajonit, do të kontribuojmë në forcimin e lidhjes mes këtyre vendeve dhe Amerikës. Do të vazhdojmë bisedimet mbi atë si të përfortojmë bashkëpunimin tonë bilateral edhe atë si SHBA-të ende mund të mbështesin Ballkanin Perëndimor", tha Pence në deklaratën e përbashkët para gazetarëve me kryeministrin malazez Dushko Markoviç. Ai shprehu bindjen se ardhmëria e Ballkanit Perëndimor është në Perëndim. "Fuqishëm besojmë se ardhmëria e Ballkanit

Perëndimor është në Perëndim. Andaj edhe sot do të bisedojmë për forcimin e lidhjes mes Bashkimit Evropian, Ballkanit Perëndimor dhe SHBA-ve", shtoi Pence. Kryeministri malazez Markoviç tha se dita e sotme është tregues se në "bashkësinë ndërkombëtare nuk ekzistojnë të mëdhenj dhe të vegjël kur është fjala për përkatësinë e idealeve" dhe se mbajtja e Samitit të Kartës së Adriatikut në Podgoricë është një ditë e madhe dhe e rëndësishme për Malin e Zi, po aq e rëndësishme është edhe për Maqedoninë. "Zëvendëspresident Pence ju jeni zyrtari më i lartë i SHBA-ve në

historinë e marrëdhënieve me Malin e Zi që na viziton neve. Ky është konfirmim i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit të të dyja vendeve. Jemi falënderues për mbështetjen e SHBA-ve ndaj Malit të Zi për realizimin e qëllimit strategjik, anëtarësimin në NATO. Kjo është e një rëndësie të gjerë, për tërë rajonin dhe dëshmi e forcës dhe qëndrueshmërisë së perspektivës së Ballkanit Perëndimor", theksoi Markoviç. Dëshmia e partneritetit, tha Markoviç, manifestohet me angazhimin në kuadër të anëtarësimin 14 vjeçar në Kartë se në këtë moment veprojnë bashkërisht në Afganistan.

Në ndërkohë, kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev tha se Maqedonia e intensifikon bashkëpunimin me vendet e rajonit dhe pret që të bëhet anëtarja e 30-ta e NATO-s. Zaev në fjalimin e Samitit theksoi se anëtarësimi i Malit të Zi në NATO paraqet inkurajim, sepse tregon se të gjithë mund të ngriten dhe të kontribuojnë për nevojat kolektive, por edhe për nevojat dhe interesat e qytetarëve të saj. "Presim që Maqedonia të bëhet anëtare e 30-të e NATO-s. Punojmë në mënyrë energjike për bashkëpunim në rajon, hapemi drejt fqinjëve. Dje e kemi nënshkruar marrëveshjes edhe me vendet tjera të rajonit", theksoi Zaev. Këto hapa që i ka ndërmarrë Qeveria e re e Shkupit, sipas tij, duhet të kontribuojnë për zhvillim të Maqedonisë dhe të rajonit. Zaevi shfaq shpresë se kjo do ta nxitë dhe përshpejtojë procesin e integritetit të Maqedonisë në BE dhe NATO. Ai paralajmëroi se Maqedonia në të ardhmen në mënyrë më aktive do të kycet në misionet e NATO-s dhe do ta rrisë buxhetin për mbrojtje. "Jemi të inkurajuar nga optimizmi, besimi dhe mbështetja



Shënohet manifestimi për Ilindenin

Kokë ulur para të ardhmes

Pas fjalimit në të cilin morën pjesë anëtarë të qeverive dhe të parlamenteve të të dy vendeve, përfaqësues të partive politike dhe të korit diplomatik, dy kryeministrat, Zaev dhe Borisov vendosën lule dhe u përkulën para varrit të Goce Dellçevit. Me ceremoninë e djeshme në varrin e Goce Dellçevit përfundoi vizita dyditëshe e kryeministrit të Bullgarisë, Borisov në Maqedoni, në kuadër të së cilës u nënshkrua Marrëveshja për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 2 gusht - Ta kalojmë të shkuarën dhe të tanishmen për shkak të së ardhmes së Maqedonisë, porositi kryetari i Qeverisë së Maqedonisë, Zoran Zaev para përkuljes së djeshme të përbashkët me kryeministrin e Bullgarisë, Bojko Borisov para varrit të Goce Dellçevit në kishën Shën Spasi në Shkup. "Presim që secili të sendërtohet në proceset të cilat shkruajnë histori të re për Republikën e Maqedonisë", theksoi kryeministri Zoran Zaev dhe bëri thirrje për unitet. Ai bëri thirrje për përgjegjësi maksimale dhe seriozitet të të gjithë qytetarëve dhe institucioneve dhe theksoi se kjo është koha kur bëjmë hap përpara. Iu referua Manifestit të KAÇKM-së. "Çfarë Maqedonie do të ndërtojme, të tillë edhe do ta kemi", tha Zaev. Maqedonia, shtoi ai, dha shembull se si të shkohet përpara. Ai shtoi se rajoni filloi të sillt në mënyrë evropiane dhe për këtë arsye meriton mundësi që anëtarët e BE-së dhe të NATO-s e njohën në Trieste, ndërkaq e njëjta pritet sot në Podgoricë nga nënpresidenti amerikan, Majk Pens. Zaev nënvizoi se Maqedonia ia ofron dorën edhe fqinjëve të tjerë. Ai sërish foli për Ilindenin, duke cekur se duhet ta dëgjojmë porosinë e Dellçevit dhe të mos humbet kohë. Pas fjalimit në të cilin morën pjesë anëtarë të qeverive dhe të parlamenteve të të dy vendeve, përfaqësues të partive politike dhe të korit diplomatik, dy kryeministrat, Zaev dhe Borisov vendosën lule dhe u përkulën para varrit të Goce Dellçevit. Me ceremoninë e djeshme në varrin e Goce Dellçevit përfundoi vizita dyditëshe e kryeministrit të Bullgarisë, Borisov në Maqedoni, në kuadër të së cilës u nënshkrua Marrëveshja për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim.

Marrëveshja hap dyer për ndërtim të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit

Marrëveshja është rezultat i kompromiseve, të cilat nuk munden të kënaqin gjithkënd. Marrëveshje të këtilla janë pasqyrë e kompromisit që duhet të shihet nga aspekti i të ardhmes, e jo i të kaluarës. Ju



SHBA: MARRËVESHJA ME BULLGARINË, SHEMULL PËR ZGJIDHJE TË QETË TË PROBLEMEVE

Departamenti i Shtetit amerikan e përshëndeti nënshkrimin e Marrëveshjes për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim midis Maqedonisë dhe Bullgarisë, duke e vlerësuar si shembull për zgjidhje të qetë të problemeve midis fqinjëve. "Shtetet e Bashkuara të Amerikës i urojnë Bullgarisë dhe Maqedonisë për nënshkrimin e Marrëveshjes për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim. Kjo marrëveshje e rëndësishme, perspektive i pranon lidhjet e fuqishme tani të vendosura midis dy vendeve dhe e hap derën për bashkëpunim edhe më të afërt në sfera të ndryshme si infrastruktura dhe kultura. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje do të kontribuojë për stabilitet politik dhe zhvillim ekonomik në rajonin më të gjerë dhe ofron shembull inkurajues për atë se si dallimet midis fqinjëve mund të zgjidhen në mënyrë të qetë", thuhet në kumtesën nga Departamenti i Shtetit amerikan.

EDHE NATO E PËRSHËNDET MARRËVESHJEN ME BULLGARINË

E përshëndesim Marrëveshjen për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim që më 1 gusht e nënshkruan kryeministri Bojko Borisov dhe Zoran Zaev, deklaroi zëvendëssekretarja e përgjithshme e NATO-s, Rouz Gotemeler. "NATO e përshëndet frymën e bashkëpunimit që e ka bërë të mundur nënshkrimin e Marrëveshjes. Kjo marrëveshje është ngjarje e rëndësishme në krijimin e marrëdhënieve pozitive në rajon me shikim drejt të ardhmes. Zbatimi i tij do të kontribuojë për sigurinë në Ballkan, e cila është në interes të të gjithëve", theksoi zëvendës-sekretarja e përgjithshme e NATO-s, Gotemeler.



bëj thirrje dy Qeverive që të kontribuojnë drejt plotësimin të qëllimit të marrëveshjes, duke përfshirë edhe përmes komisionit të përzier, i cili duhet të punojë në ndërtimin e besimit dhe miqësisë, porositi presidenti i Republikës së Maqedonisë, Gjorge Ivanov, në fjalimin e shënimit të festës shtetërore Ilinden. "Nga vetë fillimi i procesit kam insistuar që marrëveshja të jetë simetrike. Çka do të thotë kjo? Fqinjësia e mirë është e rrugë me dy drejtime. Kjo marrëveshje nënkupton se rregullat e njëjta vlejnë edhe për anën e djathtë edhe të majtë të rrugës. Ajo që vlen për Maqedoninë, vlen edhe për Bullgarinë. Duke u përmbajtur në parimet e barazisë dhe reciprocitetit, mbyllim një çështje të hapur që i ngarkonte raportet tona. Dhe, njëkohësisht, hapim

derë për ndërtim të besimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë", tha presidenti Ivanov. Ai theksoi se nga fillimi i mandatit të parë angazhohet për avancimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore me të gjithë fqinjët edhe atë në bazë të parimeve të respektit të ndërsjellë, ndihmë dhe mbështetje. Njohja e pavarësisë së Republikës së Maqedonisë nga ana e Republikës së Bullgarisë dhe Ditës së Evropës - 9 Majit, janë ngjarjet, të cilat, siç theksoi presidenti i Maqedonisë, ai ka propozuar bashkërisht të festohen.

Angushev: Ta ndërtojmë Maqedoninë si shtet qytetar të barabartë për të gjithë

Në historinë shtetformuese dhe në vazhdimësi të një populli, deklaratat, dokumentet,

vendimet dhe rezolutat e miratuar, janë moment i rëndësishëm. Por, ajo që është akoma më me rëndësi janë parimet vizionare, idealet dhe idetë në bazë të të cilave shtetformimi shndërrohet në tregim të vërtetë, në kod me të cilin do të identifikohen të gjithë qytetarët me shtetin që po krijohet si i përbashkët për të gjithë, porositi nga Pelince zëvendëskryeministri për çështje ekonomike, Koço Angushev. Në fjalimin me rastin e Ilindenit, Angushev bëri thirrje ta ndërtojmë Maqedoninë si shtet qytetar, atdhe të lirë të të gjithë qytetarëve dhe të gjitha bashkësive etnike. Sipas tij, po ndryshojnë, dhe duhet të ndryshojnë garniturat në pushtet në një bend demokratik. Por, ajo që duhet të jetë e përbashkët për të gjithë, është qëllimi i ndershëm dhe puna e përkushtuar për të mirën e të gjithë qytetarëve. Ai edhe njëherë i transmetoi, siç tha, porositë e qarta, të sakta dhe mbështetjen nga miqtë e sinqertë dhe strategjik nga Bashkimi Evropian të thëna në Samitin e paradokohshëm në Trieste, se Maqedonia, qytetarët e Maqedonisë, Qeveria e re, Kuvendi dhe e tërë shoqëria, ka mbështetje të madhe për zbatimin e reformave thelbësore dhe për përcaktimin për integrim në BE.

XHAFERI: KEMI ATDHE TË PËRBASHKËT

Duhet të jemi krenarë që para më shumë se një shekulli paraardhësit tanë kanë folur dhe kanë luftuar për liri, për respektim të së drejtave të njeriut, për bashkëjetesë dhe tolerancë, për shoqëri multikulturore dhe multietnike. Udhëheqësit e Kryengritjes së Ilindenit Nikola Karev, Goce Dellçev, Dame Gruev, Pitu Guli dhe heronj të tjerë të ditur dhe të paditur, tregojnë se kanë pasur vlera dhe parime civilizuese lartë të zhvilluara për unitet, theksoi kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi nga Meçkin Kamen në shënimin qendror të Ilindenit - Ditën e Republikës. Fjalimin ai e filloi me citim në Manifestin e Krushevs nga viti 1903 i cili ka bërë thirrje për bashkim në realizimin e qëllimit të përbashkët - lirinë - deri te të gjithë banorët, pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare dhe etnike dhe status social. Dokumenti i shkruar para 114 viteve por i cili, tha Xhaferi, është aktual edhe sot. Këto vlera dhe parime civilizuese kanë qenë motivim, tha Xhaferi, në vitin 1941 njerëzit nga përkatësi të ndryshme etnike dhe feja sërish së bashku të ngrihen kundër fashizmit dhe të luftojnë për liri. Dëshira shekullore për shtet të pavarur u realizua më 8 Shtator të vitit 1991, tha Xhaferi, ndërsa konstanca e vulosur në Manifestin e Krushevs për karakterin multietnik, multikulturore dhe multifunksional është konfirmuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

nga qytetarët tanë, si dhe nga mbështetjet e SHBA-së. Ky është motiv i fuqishëm si kryeministër ta justifikoj besimin dhe t'i realizoj pritjet. Kjo që sot me ne është nënkryetari i SHBA-së tregon se Maqedonia dhe vendet e Ballkanit Perëndimor kanë partner të besueshëm. Jemi koshientë se rajoni dhe kjo pjesë e botës është pjesë strategjike për sigurinë globale", tha Zaev. Kryeministri i Maqedonisë, së bashku me kryeministrin e Malit të Zi, Dushko Markoviq, është bashkënikoqir i Samitit të vendeve anëtare të Kartës së Adriatikut me të cilën kryeson Republika e Maqedonisë. Është paraparë që Zaev sot në Podgoricë të ketë takim bilateral me nënpresidentin amerikan Pens. Në Samitin e vendeve nga Karta e Adriatikut marrin pjesë edhe kryeministrat e Shqipërisë, Edi Rama, Kroacisë, Andreja Plenkoviç, Malit të Zi, Dushko Markoviq dhe të Bosnjës e Hercegovinës, Denis Zvizdiq, si dhe të vendeve vëzhguese, Serbisë, me kryeministren Ana Bërnabiq, Kosova me presidentin Hashim Thaçi dhe Sllovenia me kryeministrin Miro Cerar. Në përbërjen e delegacionit të Republikës së Maqedonisë janë edhe zëvendëskryetarja e Qeverisë dhe ministre e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska Jankovska, zëvendëskryetari i Qeverisë, i angazhuar për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë dhe sistemit politik, Hazbi Lika, ministri i Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov dhe deputeti Stevo Pendarovski.



Në vitin 2014, në Maqedoni janë regjistruar 180 vetura në 1000 banorë që është një rritje e madhe në raport me afër 122 vetura në 1000 banorë në vitin 2007, tregojnë të dhënat statistikore

Nga shtetet e rajonit, Maqedonia me 180 në 1000 banorë ka më shumë vetura vetëm se Kosova dhe Shqipëria që kanë afër 150 vetura në 1000 banorë, ndërsa ka më pak vetura se të gjitha shtetet në Ballkanin Perëndimor

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 2 gusht - Në vitin 2014, në Maqedoni janë regjistruar 180 vetura në 1000 banorë që është një rritje e madhe në raport me afër 122 vetura në 1000 banorë në vitin 2007, tregojnë të dhënat statistikore. Kjo, me fjalë të tjera i bie se gati çdo i pesti i banor në vend posedon një veturë. Këtë e tregon përlllogaritja prej gati 180 mijë vetura në një milion banorë, gjegjësisht numri i 360 mijë veturave në 2 milionë banorë e që tregon se gati çdo i pesti banor në Maqedoni posedon veturë për ngasje. Nga shtetet e rajonit, Maqedonia ka më shumë vetura vetëm se Kosova dhe Shqipëria, ndërsa ka më pak se të gjitha shtetet tjera në Ballkanin Perëndimor. Sipas të dhënave krahasuese të Entit të Statistikës së Maqedonisë - "NationMaster", që grumbullon më shumë të dhëna statistikore nga lëmi të ndryshme, si dhe Zyrës Evropiane të Statistikave - EUROSTAT, Maqedonia me 180 vetura në 1000 banorë ia kalon Shqipërisë që ka 140 vetura në 1000 banorë dhe Kosovës me 150 vetura në 1000 banorë. Nga shtetet e rajonit, numër më të

Maqedoni, 180 vetura në 1000 banorë

Çdo i pesti me veturë



PAGUHEN 46 MILIONË DENARË DËMSPËRBLIM PËR VËRSHIMET E VJETSHME NË HASANBEG

Gjatë ditës së martë janë paguar rreth 46 milionë denarë për kompensimet e dëmeve nga përmblytjet që kanë ndodhur në vitin 2016 në Komunën e Gazi Babës, më saktë për dëmet e serrave dhe për të mbjellat shumëvjeçare, informoi sot ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Lupço Nikollovski para banorëve të fshatit Hasanbeg. "Me këtë pagesë janë përfshirë pjesa më e madhe e sipërfaqeve të shkatërruar punuese bujqësore, në bazë të raportit për vlerësim dhe llogaritje të humbjes së fitimit, llogaria e bimëve bujqësore dhe dëmet e serrave si dhe shumë të mbjella shumëvjeçare nga përmblytjet", tha Nikollovski. Informoi se në fazën përfundimtare janë edhe një numër i vogël i sendeve, të cilave u kanë munguar dokumente të caktuara dhe procesverbale jo të plota që vlerësimi të mund të kompletohet dhe të paguhen plotësisht.

lartë të veturave se tek ne, ka në Bullgari (393 për 1000 banorë, në Kroaci (380), në Mali të Zi (309), në Serbi (238), në Rumuni (330), si dhe në Bosnjë e Hercegovinë (214). Vlerësohet se në tre vitet e

kaluara, tregu i shitblerjes në Maqedoni karakterizohet me shitje prej 20-23 mijë të veturave të vjetra si dhe trend pozitiv të shitjes së veturave të reja. Njohësit e tregut të au-

tomobilizmit në Maqedoni shpjegojnë se vitet e fundit kemi stabilizim të tregut të veturave të vjetra, për shkak të ngopjes së tregut, si dhe rritjes të tregut të veturave të reja si rrjedhojë e blerjes së

tyre edhe me kredi automobilistike, me kredi konsumatore, si dhe blerjes së veturave edhe nga një pjesë e kompanive për nevojat e tyre. Në ndërkohë, rritjen e butë të tregut të veturave të reja dhe tregun stabil të shitjes prej afër 23 mijë të veturave të vjetra në tre vitet e fundit, e mbështesin edhe të dhënat zyrtare të Doganës së Maqedonisë. Sipas tyre, në vitin 2016 ka pasur 5027 vetura të reja të importuara, në 2015 janë shënuar 4244 vetura të reja të importuar dhe në vitin 2014 janë shënuar 3052 vetura të reja të importuara.

Në ndërkohë, vitin e kaluar janë importuar 25.889 vetura të vjetra, në 2015 janë importuar 23.196 vetura të vjetra, dhe në vitin 2014 janë importuar 29.558 vetura të vjetra.

Nga ana tjetër, që nga viti 2010 e këtej, si rrjedhojë e ngopjes së tregut pas liberalizimit të kushteve për import të veturave të vjetra, është ulur gradualisht importi i veturave në tregun vendor. Këtë e tregojnë edhe të dhënat e Doganës, sipas të cilave, në vitin 2014 në Maqedoni janë importuar 29.931 vetura prej të cilave 4244 ishin të reja dhe 23.196 të vjetra, për dallim prej vitit 2010 kur në shtet janë importuar 58.582 automjete, gjegjësisht 7183 të reja dhe 51.399 të vjetra.

Karakteristikë tjetër e tregut të veturave në Maqedoni është edhe ndalesa prej muajit qershor të vitit të kaluar e importit të veturave të vjetra me standard ekologjik Euro 3 (Eko 3), kurse lejohet vetëm importi i veturave me Eko 4 dhe më lartë. Sipas vendimit qeveritar, pas 1 qershorit të vitit 2016, në Maqedoni nuk lejohet importi i veturave me standard EKO 3, që do të thotë se nuk do të mund të importohen nga jashtë vetura të prodhuara para vitit 2004. Ndryshe, shtetet me më shumë vetura në botë janë ato mbretërore në Evropë, si San Marino me 1263, Monako me 899 dhe Lihtenshtajni me 750 vetura në 1000 banorë. Nga shtetet e mëdha kryesojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me 797 vetura për 1000 banorë. Në SHBA, për shkak të distancave të mëdha, si dhe nevojës për të udhëtuar edhe me orë të tëra në vendin e punës, posedimi i një makine bëhet domosdoshmëri për çdo anëtar të familjes. Nga shtetet evropiane të zhvilluara, Italia ka numrin më të lartë me 689 vetura në 1000 banorë, edhe si rrjedhojë e pasionit të madh të italianëve për vozitje. Vendet me zhvillim të lartë, si Franca, Gjermania, Finlanda, Austria apo Zvicra duket se preferojnë edhe transportin publik, për shkak se numri i automjeteve në këto shtete luhet në 560-580 makina për 1000 banorë. Kjo është e dukshme sidomos në Danimarkë (480 vetura) dhe Suedi (520), si shtete që i kushtojnë një vëmendje të madhe ruajtjes së ambientit jetësor.

Deri të dielën duhet të miratohet rishikimi i buxhetit

VMRO ankohet se rebalanci u jep më shumë para shqiptarëve!

"Shkurtojnë 44.5 milionë denarë më pak nga Universiteti 'Shën Kirili dhe Metodi', shkurtojnë 10 milionë denarë më pak për Universitetin 'Shën Klimenti i Ohrit', 22 milionë denarë më pak për Universitetin 'Goce Dellçev' në Shtip... Në versionin e parë shkurtuan edhe nga Universiteti 'Nëna Terezë', por tani po e shoh se kanë modifikuar këtë propozim dhe bëhet e qartë se çdokund në universitetet ku mësohet në gjuhën shqipe, shtohen mjete, ndërsa aty ku mësimi zhvillohet në gjuhën maqedonase - shkurtohen fonde", akuzoi Ilija Dimovski nga VMRO

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 2 gusht - Rishikimi i buxhetit për vitin 2017, për të cilin po debatohet në seancë parlamentare, po kundërshtohet ashpër nga partia opozitare VMRO, madje duke e

akuzuar ministrin e Financave se me këtë rishikimin të buxhetit - më shumë para po u ndahen shqiptarëve se sa maqedonasve. Deputeti i VMRO-së, Ilija Dimovski, në ditën e parë të seancës plenare në të cilën filloi debati, akuzoi ministrin e Financave, Dragan Tevdovski, se përveç që parashihen më shumë para për projekte shqiptare, njëherësh me rishikimin e buxhetit kjo Qeveri po shkurton buxhetin për universitetet me mësim në gjuhën maqedonase, ndërsa e rrit shumën e parave për universitetet me mësim në gjuhën shqipe. "Shkurtojnë 44.5 milionë denarë më pak nga Universiteti 'Shën Kirili dhe Metodi', shkurtojnë 10 milionë denarë më pak për Universitetin 'Shën Klimenti i Ohrit', 22 milionë denarë më pak për Universitetin 'Goce Dellçev' në Shtip... Në versionin e parë shkurtuan edhe nga Universiteti 'Nëna Terezë', por tani po e shoh se kanë modifikuar këtë propozim dhe bëhet e



qartë se çdokund në universitetet ku mësohet në gjuhën shqipe, shtohen mjete, ndërsa aty ku mësimi zhvillohet në gjuhën maqedonase - shkurtohen fonde", tha Dimovski. Ministri Tevdovski akuzat e deputetëve të VMRO-së i vlerësoi si të pa baza, sepse me rishikimin e buxhetit - siç tha ai, janë shkurtuar shpenzime joproduktive të Qeverisë dhe me këto shkurtime sigurohet mundësia për buxhet të ri që nënkupton më shumë mbështetje për qytetarët dhe kompanitë vendore. "Me shkurtime

e shpenzimeve joproduktive do të sigurojmë më shumë para për pagën minimale, zgjidhje për të falimentuarit, mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe bujqit, heqje të taksës radiodifuzive... Me fjalë të tjera, kjo është pjesë e programit të Qeverisë së re që mund të realizohet në afat të shkurtër kohor. Masat e tjera të planifikuara, të cilat i presin qytetarët dhe kompanitë janë pjesë e ndryshimeve më të thella dhe të cilat do të përfshihen në buxhetin e vitit 2018, dhe për të cilat veç

kemi nisur të punojmë si ministri", deklaroi Dragan Tevdovski, ministër i Financave. Ndryshe, me rishikimin e buxhetit, i cili duhet të miratohet më datë 6 gusht - të dalat buxhetore janë zvogëluar nga 206.2 miliardë denarë në 203.3 miliardë denarë, ndërsa deficiti mbetet i njëjtë në 18.6 miliardë denarë apo rreth 302 milionë euro. Më rishikim e buxhetit të vitit 2017, më shumë para ka fituar Ministria e Shëndetësisë dhe atë 4.4 milionë euro, ndërsa shkurtime më të madh të buxhetit për 21 milionë euro ka për Ministrinë e Arsimit. Më pak buxhet me rishikim parashihen edhe për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe atë 6.7 milionë euro më pak. Më pak para për harxhime me rishikim do të kenë edhe Ministria e Mbrojtjes, ajo e Financave, Drejtësisë, Transportit, ndërsa buxhet më të lartë do të kenë Ministria e Punës dhe Politikës Sociale - 1.2 miliardë euro, Ministria e Bujqësisë, si dhe Ministria e Punëve të

Jashtme. Me rishikimin e buxhetit më shumë para janë paraparë për ndërtimin e fazës së tretë të sheshit Skënderbeu, në vlerë prej 3.4 milionë euro, me çka konsiderohet se ky projekt do të përfundojë deri në fund të këtij viti. Me para buxhetore në vlerë prej 1.2 milion euro parashihet për rinovimin e Spitalin Klinik të Tetovës, Spitalin e përgjithshëm të Kërçovës dhe kulmin e spitalit në Gostivar. Njëherësh, me para të buxhetit parashihet dhe ndërtimi i ujësjellësit dhe të kanalizimit në Vizbeg. Për universitetin "Nënë Tereza" Shkup me rishikim e buxhetit parashihen 81 milionë denarë apo 1.5 milion euro. Ndryshe, debati për rishikimin e buxhetit zgjatë pesë ditë dhe në ditën e pestë - kryetari i Parlamentit 10 minuta para orës 24 ndërpret çdo diskutim lidhur me rishikimin buxheti dhe të njëjtin e vendos në votim. Rishikimi i buxhetit llogaritet i miratuar nëse për të votojnë 61 deputetë.



Merko për vizitë në Shqipëri

Shkup, 2 gusht - Ministri për Investime të Huaja Ramiz Merko nga sot e deri më 4 gusht do të qëndrojë për vizitë zyrtare në Shqipëri, gjatë të cilit do të ketë takime me presidentin shqiptar Ilir Meta, me kryetarin e Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, me përfaqësues të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë si dhe me disa nga sipërmarrësit më të suksesshëm Shqiptarë. Merko do të jetë i shoqëruar nga zëvendës-drejtori i Drejtorisë për Zona Zhvillimore Teknologjike Industriale, Asip Useini dhe nga drejtuesi i Zyrës Ndërkombëtare "FM Consulting", Fatos Mustafa. Në kumtesën nga kabineti i Merkos, thuhet se vizita është në kuadër të krijimit të një zone të përbashkët ekonomike rajonale, të mbështetur nga Samiti i Triestes që u mbajt në korrik të këtij viti do të shërbejë si një mundësi për qeverinë dhe biznesin shqiptar për t'u njohur me modelin e ri të Maqedonisë të të bërit biznes, si dhe me politikën lehtësuese që zbaton qeveria në kuadër të përmirësimit të klimës së biznesit. Janë parashikuar të zhvillohen takime me kryetarin e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës Nikolin Jaka, me kryetarin e Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar Agim Rrapaj, me kryetarin e "Agra Group" Vasil Naçi, me kryetarin e "Mare Adriatik" Mark Babani, me Maksim Caslin, drejtuesi i "Deloitte Albania & Kosovo", me kryetarin e "Aiba Kompani" Agron Duka, me kryetarin e "Green Farm" Ferdinant Bani dhe të tjerë. Merko dhe bashkëpunëtorët e tij do të prezantojnë modelin e ri të tërheqjes së investimeve të Qeverisë së Maqedonisë, pjesë e së cilave janë edhe subvencionet që ofrohen për biznesin që investojnë në Zonat Zhvillimore Teknologjike Industriale, por edhe jashtë tyre. Qeveria Maqedonisë, në këto zona ofron një sërë lehtësish që përfshijnë edhe çlirime nga barra fiskale për një periudhë prej rreth 10 vitesh. Drejtuesi i Zyrës Ndërkombëtare "FM Consulting", Fatos Mustafa, thotë se Maqedonia dhe Shqipëria si vende fqinje duhet bashkërisht të kërkojnë mundësitë për të bashkëpunuar, për të qenë sa më plotësues të njëri-tjetrit pasi vetëm kështu mund të integrohen në tregje më të mëdha. Për Zyrën Ndërkombëtare "FM Consulting" këto takime mes përfaqësuesve të së dy qeverive, por edhe të biznesit janë shembulli më i mirë se si Maqedonia dhe Shqipëria duhet të rrisin më tej bashkëpunimin për të forcuar pozitat e tyre, si dhe për të garantuar më shumë konkurrencë dhe një klimë sa më të favorshme për sipërmarrjen në të gjitha fushat me interes të përbashkët, si industria, turizmi etj... (Z.V)

"Fatmirësisht, dëme materiale nuk kemi pësuar, megjithatë nga flakët e zjarrit ka pësuar një trafostacion i rrymës 10 megavat, i cili e ka lënë të gjithë fshatin pa rrymë. Si rrjedhojë e djegës së këtij trafostacioni, ne kemi ngelur edhe pa ujë të pijshëm për shkak se në mungesë të rrjetit të ujësjellësit, ne e shfrytëzojmë sistemin e hidroforit për tu furnizuar me ujë të pijshëm", tha kryetari i bashkësisë lokale të fshatit Nigishtan, Bejadin Osmani

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 2 gusht - Fusha, male dhe kodrina ditëve të fundit janë përfshirë nga zjarret. Në fshatrat përreth qytetit të Shkupit, siç janë Bukoviqi, Kondova e Nigishtani flaka e zjarreve ka djegur një sipërfaqe të konsiderueshme të barishteve të thata. Ndonëse nga organet kompetente ende nuk kanë dalë me raport zyrtar se cilat janë faktorët kryesor të përhapjes së zjarrit në këtë rajon, banorët e këtyre fshatrave vlerësojnë se pakujdesia e qytetarëve ka ndikuar në shkaktimin e këtyre zjarreve. Kryetari i bashkësisë lokale të fshatit Nigishtan, Bejadin Osmani, në prononcimin e tij për gazetën KOHA, thotë se pas shumë viteve - për herë të parë zjarri në rajonin e tyre është paraqitur mbrëmjen e 1 gushtit. "Pavarësisht se policia dhe zjarrfikësit nuk kanë ende arsytet e përhapjes së këtij zjarri, unë jam i mendimit se neglizhenca qytetare në radhë të parë është shkaktar i këtij zjarri, pastaj nuk i përjashtoj edhe temperaturat e larta. Gjatë mbrëmjes së 1 gushtit dhe mëngjesin e 2 gushtit, ekipet e zjarrfikësve në vazhdimësi janë angazhuar në shuarjen e zjarreve dhe lokalizimin e tyre. Fatmirësisht, dëme materiale nuk kemi pësuar, megjithatë nga flakët e zjarrit ka pësuar një trafostacion i rrymës 10 megavat, i cili e ka lënë të gjithë fshatin pa rrymë. Si rrjedhojë e djegës së këtij trafostacioni, ne kemi ngelur edhe pa ujë të pijshëm për shkak se në mungesë të rrjetit të ujësjellësit, ne e shfrytëzojmë sistemin e hidroforit për tu furnizuar me ujë të pijshëm", tha Osmani për gazetën KOHA. Përveç në këtë rajon, sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, zjarret gjatë ditëve të fundit janë paraqitur dhe regjistruar edhe në fshatin Graçan, i cili kufizohet me pikën kufitare në Billacë. Ndërkohë, fshatrat tjerë të rajonit të Dervenit që janë përfshirë nga zjarret janë Kopanica, Rotinca dhe fshati Radushë, të cilët me ndihmën e ekipeve të zjarrfikësve dhe banorëve vendas, kanë arritur të lokalizohen dhe shuhet. Nga ana tjetër, banorët e fshatit Kondovë të Komunës së Sarajit janë ankuar se ekipet e zjarrfikësve nuk ju kanë dalë në ndihmë gjatë shuarjes së zjarrit, por ato janë organizuar individualisht dhe kanë arritur ta shuajnë zjarrin që është shkaktuar buzë

Kujdes! Shumë pyje në Maqedoni përfshihen nga zjarret

Zjarri lë Nigishtanin pa rrymë e pa ujë



NDIHMË NGA BULLGARIA PËR BALLAFAQIM ME ZJARRET

Helikopter MI17 me ekuipazh prej 12 persona, dërgoi Republika e Bullgarisë në Maqedoni si ndihmë për ballafaqim me zjarret. Ndihmën e kërkoi Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH), ndërsa ekipi bullgar është pritur nga kryeministri Zoran Zaev dhe nga përfaqësues të DMSH-së dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë. Pas pritjes është realizuar koordinim dhe helikopteri është dërguar në lokacion përkatës, për shuarje të zjarrit në komunën Makedonski Brod. Siç kumton DMSH, Maqedoninë këtyre ditëve e përfshinë zjarre nga përmasa të mëdha, por edhe krahas angazhimit të ekipeve për mbrojtje dhe shpëtim dhe aviacionit, është kërkuar ndihmë plotësuese nga Bullgaria.

PJESË TË MAQEDONISË NË FAZËN PORTOKALLI, TEMPERATURAT DERI 42 GRADË

DPHM kumtoi se vazhdon periudhë e motit kryesisht me diell dhe shumë të nxehtë. Në pjesën më të madhe të Maqedonisë, temperatura do të jetë mbi 35, ndërsa në disa vende përgjatë Vardarit do të tejkalojë edhe 40 gradë. Sidomos ngrohtë do të jetë sot kur temperatura maksimale në rajonet më të ngrohta do të arrijë deri 42 gradë, ndërsa UV indeksi vlerën 9. Sipas temperaturave të parashikuara, sot rajoni i Maqedonisë do të jetë në fazën e verdhë, ndërsa nesër rajoni i Vardarit verior dhe i Ohrit-Prepsë në fazën portokalli.

shtëpive të tyre, gjegjësisht helikopteri i cili gjatë ditës ka qarkulluar mbi shtëpitë e tyre ndërsa ndihmë për shuarjen e zjarreve ka dërguar vetëm në rajonin e fshatit Orman, që kufizohet me atë të Nigishtanit. Ndryshe, për dhjetë ditë të plota zjarret në rajonin e Makedonski Brodit ende janë aktive. Sipas informacioneve paraprake, deri më sot zjarret në këtë rajon kanë djegur rreth 400 hektarë të pyjeve të mbuluara me pisha. Situata kritike dhe tepër e rrezikshme ka ndikuar që Qendra për Menaxhim me Kriza(QMK) të kërkoj

ndihmë ndërkombëtare për shuarje e zjarreve në këtë rajon. Drejtoria i QMK-së, me këtë rast ka theksuar se nga aksionet e deritanishme për shuarjen e zjarreve në këtë rajon, janë mbledhur prova se ky zjarr është shkaktuar nga faktori njeri. Lidhur me këtë situatë të krijuara Qeveria në takimin e fundit ka sjellë vendim që në procesin e shuarjeve të zjarreve të përfshihet edhe ushtria, ndërkaq nëpunësit e MPB-së janë obliguar që ta shtojnë prezencën e tyre në rajonet e rrezikshme. Me qëllim parandalimin e

përhapjes së zjarreve tjera, nga Ndërmarrja Publike "Parqe dhe Gjellbërime" - Shkup, ju kanë apeluar qytetarëve që ta mënjanë vizitën e malit të "Vodnos" gjatë periudhës që pason. Ky apel sidomos vlen për ato qytetar që gravitojnë në këtë rajon gjatë orëve të vona të natës. Temperaturat e larta që pasojnë në ditët në vijën paraqesin rrezik potencial për përhapjen e zjarreve, për këtë arsye apelojmë që qytetarët t'i përmbahen vizitave të malit "Vodno", gjegjësisht hedhjes së mbetjeve nga duhani, ndezja e zgarës e kështu me radhë", thuhet në kumtesën zyrtare të NP "Parqe dhe Gjellbërime"-Shkup. Sidoqoftë, ky apel për vetëdijesimin e popullatës vlen edhe për ato qytetar të cilët e vizitojnë malin rekreativ të "Gazi Babës", të cilët gjatë orëve të pasdites në të shumtën e rasteve fushat e thata i shfrytëzojnë për pushime dhe ndezjen e bombolave me gaz me qëllim përgatitjen e kafeve apo çajit.

AKOMA AKTIV ZJARRI NË TREBOVLE, NË ORMAN ËSHTË LOKALIZUAR

Zjarri në atarin e fshatit Trebovlë, komuna Makedonski Brod, akoma është aktiv, por tash për tash është evituar përhapje e tij drejt fshatrave Rastesh dhe Trebovle. QMK kumtoi se në terren veprojnë dy aeroplanë të DMSH, ndërsa pritet edhe aktivizim i dy helikopterëve të ARM-së. Zjarrin e shuajnë edhe ekipe të njësitëve zjarrfikës territorialë nga Makedonski Brodi, Shkupi, Kumanova dhe në NP Pyjet e Maqedonisë, si dhe pjesëtarë të DMSH, të ARM-së, vullnetarë dhe popullata lokale. Aktiv është zjarri edhe në shpatet e Jakupicës së Epërme afër Velesit. Është përfshirë edhe pyll i përzier (pisha dhe ah). Në shuarjen e zjarrit janë angazhuar të punësuar në Ekonominë pyjore Babuna, Veles. Në territorin e Qytetit të Shkupit sot nuk ka regjistruar zjarre pyjore aktive. Zjarri që ka shpërthyer dje në fshatin Orman në Komunën Gjorqe Petrov është lokalizuar mbrëmë rreth 23.00. Në shuarjen e tij kanë marrë pjesë pjesëtarë të Brigadës së zjarrfikësve, persona nga popullata vendore, si dhe të punësuar në shërbimet komunale pranë komunës Gjorqe Petrov.



Konsumatorët dibranë kanë të drejtë të ankohen

Shalqiri me shije të ëmbël, por i hidhët në treg

Kualiteti i shalqirit dibran ka qenë dhe mbetet i njëjti, thonë prodhuesit. Por, vet fakti se dukshëm është ulur sasia e prodhimit, kjo ndikon edhe te çmimi në treg. Sot në tregun dibran, çmimi i shalqiri vendas është pothuajse 30 për qind më lartë se vitin e kaluar

Koha Vjollca SADIKU

Dibër, 2 gusht - Edhe kësaj vere i gëzohemi frytit të shalqirit, pasi që ai jo vetëm që është i shijshëm dhe i ëmbël, por na jep një freski gjatë këtyre ditëve të nxehta. Në Dibër tradicionalisht bujqit kanë mbjellë sipërfaqe të mëdha me shalqi. Ky fryt, sidomos në fshatrat kufitare ka qenë prezent në sipërfaqe të gjëra nga të cilët pastaj bujqit kanë përfituar materialisht. Shalqiri, një fryt i bekuar edhe sivjet është prezent në tregun e Dibrës. Ndoshta jo ashtu siç ka qenë para disa dekadave, kur kryesisht furnizimi i tregut dibran është bërë nga fermerët vendas, por përsëri shalqiri dibran kërkohet nga pjesa më e madhe e konsumatorit. Por, këtë verë përsëri shalqiri është i ëmbël, por çmimet të tij në treg janë të hidhët. Edhe pse përveç shalqirit vendas ka edhe sasi të mëdha të shalqirit nga vise të tjera të vendit, çmimet siç thonë dibranët, janë shumë më të larta në krahasim me



vitet e kaluar.

Shalqiri që plasohet në tregun dibran nga Strumica, Gjevgjelia dhe qytet të tjera të lindjes, është diçka më i lirë, por ai assesi nuk mund të zëvendësojë shijen tejet të ëmbël dhe kualitetin e shalqirit vendas.

Kur jemi tek prodhuesit e shalqirit, sipas prodhuesit dibran, Osman Kazani, i cili vazhdon në sipërfaqe të tij bujqësore të mbjellë këtë fryt, sa i takon sasisë, ka një rënie të dukshme. Fshatarët migruan dhe janë shumë pak bujq, të cilët merren me pemëtari dhe kopshtari. Është krejt normale, thotë ai, që kur prodhohet më pak, të ketë një rritje të çmimeve. Familja jonë, shton ai, ka prodhuar disa herë më shumë shalqi dhe pjeper dhe pa probleme është shitur shpejt në tregun e Dibrës. Por, njëkohë-

sisht kemi furnizuar tërësisht fshatrat e Zhupës dhe Rekës, shton Osman Kazani.

Në shoqatën e bujqve dibranë thonë se kultivimi i shalqirit gjithmonë ka qenë i suksesshëm. Dibra posedon kushte shumë të mira për prodhimin e shalqirit dhe pjeperit. Gjatë verës, siç thonë bujqit, turistët të shumtë që vizitojnë banjat e Dibrës në të dy lokalitet, Banjisht dhe Kosovrast, por edhe turistët të tjerë, kërkojnë në tregun e Dibrës vetëm shalqirin dhe pjeperin dibran.

Kur bëjmë fjalë për kopshtarinë dhe pemëtarinë e rajonit më të gjerë të Dibrës, ulja e prodhimit ka të bëjë edhe me mosfunksionimin e sistemit të vaditjes së fushës së Dibrës. Agronomi i njohur dibran, Gazmend Ajdaraga, thekson se dekadën e fundit kultivimi i shalqirit ngec, meqë bujqit e fshatrave

kufitare janë më të paktë. Para më shumë se dy dekadave nga shalqiri dhe shitja e tij, është jetuar shumë mirë dhe shumë familje kanë pasur kultivimin e tij si element primar. Prandaj, kompetentët duhet të ndërrojnë të gjitha aktivitetet për rifunksionimin e sistemit për vaditje të fushës së madhe të Dibrës, thotë Ajdaraga.

Ekspertët thonë se Dibra është e njohur për gështenjën, specat, domatet, por edhe për shalqirin. Por, tregu dibran është ai i cili duhet furnizuar me shalqirin e ëmbël vendor, por jo edhe me çmime të hidhura, thonë konsumatorët. Standardi teje i ulët dibranëve, meqë 1 e 3 e popullatës jeton me ndihma sociale, sigurisht se kërkon edhe çmime më të volitshme kur bëhet fjalë për furnizimin me prodhimet bujqësore.

Këshilli i Komunës së Gostivarit



Mjete për familjen Miftari

Gostivar, 2 gusht - Në seancën e 39-të me radhë të Këshillit të Komunës së Gostivarit, këshilltarët me shumicë prej 29 votash miratuan propozim - vendimin për ndarje të mjeteve financiare për familjen Miftari nga fshati Simnicë, në vlerë prej 180 mijë denarë. Në drejtim të ndarjes së mjeteve financiare nga buxheti i Komunës së Gostivarit, këshilltarët miratuan propozim - vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për Klubin e futbollit "Gostivari", me vlerë prej 1 milion denarë. Klubi i Gostivarit, në stinorin e ri do të garon në ligën e dytë republikane.

Mjete financiare u ndanë edhe për dy shkollat e mesme publike të Komunës së Gostivarit, Gjymnazin dhe Shkollën Ekonomike. Këshilltarët miratuan propozim - vendim për ndarjen e mjeteve financiare Shkollës së Mesme Komonale "Gostivari", edhe atë 145 mijë denarë për procesin e mbikëqyrjes të sallës sportive, si dhe 313 mijë denarë për rinovimin të sistemit të nxemjes qendrore. Po ashtu, u aprovua propozim - vendimi për ndarjen e mjeteve financiare SHMEK "Gostivar" - Gostivar, me vlerë 90 mijë denarë për rinovimin e shkollës.

Me shumicë votash, u miratuan propozim - konkluzionet për dhënie pëlqim vendimit për miratimin e raporteve financiare të NP "Parkingu i qytetit dhe gjelbërim", dhe NP "Komunalec". Nga sfera e urbanizimit, këshilltarët miratuan propozim - vendimin e PDU-së për Bllok 19, KK Gostivar 1 - për periudhën e planit (2016-2021), sipërfaqe të përfshirjes (31.845 ha), si dhe disa propozim - vendime për sjelljen e dokumentacionit planor urbanistik dhe për sjelljen e dokumentacionit planor urbanistik për persona fizikë.

Edhe këtë verë parkingu "sëmundje kronike"

Dibër, 2 gusht - Parkingu në qytetin e Dibrës vazhdon të jetë problem kryesor në sferën e komunikacionit. Sidomos ky problem vjen në shprehje gjatë ardhjes të mërgimtarëve me automjetet të tyre për të kaluar pushimet në vendlindje. Këto ditë vërehet një fillim i kaosit në komunikacion e veçmas në rrugët kryesore të qytetit. Problemi i parkimit të automjeteve që zvarritet vite me rrallë tentohet të zgjidhet. Pushteti vendor aktual, por edhe ai i mëparshëm, janë të vetëdijshëm që parkingu i automjeteve duhet të zgjidhet një herë e përgjithmonë. Përcaktimi i komisionit për sigurimin në komunikacion pranë këshillit të Komunës Dibër para disa vjetëve vendosën që e rruga kryesore "8 Shtatori" të jetë njëkahëshe, dhe lëvizja e automjeteve të jetë në një



korsi. Ky vendim respektohet edhe tani, por rruga në fjalë ndihmon parkimin e automjeteve por nuk e zgjidh problemin.

Nëse kemi parasysh faktin se në Komunën e Dibrës numri i automjeteve të regjistruara është afër 3 mijë, kurse për afërsisht gjatë verës rritet

frekuentimi nga mërgimtarëve tanë që jetojnë kryesisht në Europën Perëndimore, atëherë shumë qarët shihet se problemi i kaosit në komunikacion edhe këtë verë ndjehet dhe është aktual sikur "simptomat e viruseve sezonale". Në këtë drejtim, një pengesë

të madhe bëjnë edhe vet pronarët të shitoreve në rrugën qendrore, të cilët vazhdimisht parkojnë automjetet e tyre para objekteve afariste. Por, duhet theksuar se viteve të fundit në qytet, sidomos në qendër ka një frekuentim të madh të automjeteve edhe nga

shtetasit e Shqipërisë, respektivisht të viseve kufitare të cilët vijnë në Dibër ose për të tregtuar, vizituan apo thjesht për një relaks.

Institucionet lokale në kontinuitet kanë përcaktuar vend për parkimin e taksi automjeteve, por edhe për përcaktimi i furgonëve të cilët mbajnë linja të rregullta mes Dibrës dhe fshatrave të rajoneve Zhupë dhe Rekë. Duke marrë parasysh nevojën të madhe për të parkuar automjetet shpesh herë qytetarët apo mërgimtarët cenojnë të drejtën e vendeve të përcaktuara për parkingun të taksi automjeteve dhe furgonëve në fjalë. Komisioni për sigurinë në komunikacion po ashtu ka debatuar disa herë rreth këtij problemi. Ky institucion lokal është i mendimit se definitivisht Dibra duhet të ndërtojë

një parkim më të madh. Ka variante të ndryshme rreth ndërtimit të parkingut, me çka janë bërë edhe përcaktime urbanistike. Pritet që këto përcaktime të realizohen. Edhe pushteti vendor ka plan programin për realizimin e projektit për një parking, me çka priste të realizohet për një kohë të shkurtër. Deri atëherë mbetet që sidomos gjatë verës të ballafaqohemi me situatën kaotike në komunikacion.

Nga kjo situatë pësojnë edhe këmbësorët, por edhe pronarët të garazheve të cilët gjenden në qendër të qytetit. Ndosht që shpesh herë automjetet të parkohen në trotuares ose para garazheve. Edhe pse policia e qarkullimit rrugor ka ndërmarrë aktivitet të shumta dhe zbaton Ligjin për komunikacion, problem në fjalë mbetet prezent. (V.S.)

KONKURS PËR MËSIMDHËNËS NË TË GJITHË THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE DHE BASHKËPUNËTORË (ASISTENTË - DOKTORANTË) NË UNIVERSITETIN "NËNË TEREZA" NË SHKUP

Në bazë të nenit 131 paragrafi 1 të Ligjit për Arsimit të Lartë ("Gazeta Zyrtare" nr. 35/2008; 103/2008; 26/2009; 83/2009; 99/2009; 115/2010; 17/2011; 51/2011; 123/2012; 15/2013; 24/2013; 41/2014; 116/2014; 130/2014; 10/2015; 20/2015; 98/2015; 145/2015; 154/2015; 30/2016; 120/2016 u 127/2016), Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup, shpall:

KONKURS**Për zgjedhjen e mësimitdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore dhe bashkëpunëtorë (asistentë - doktorantë) të fakulteteve në përbërje të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup****A. FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS****A.1. Programi studimor: AKRITECTURA DHE DIZAJNI**

1. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore PROJEKTIM ARKITEKTONIK DHE DIZAJN (20100 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
2. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM URBAN DHE HAPËSINOR (20114 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
3. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore PROJEKTIM ARKITEKTONIK DHE DIZAJN (20100 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
4. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM URBAN DHE HAPËSINOR (20114 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
5. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore METODOLOGJIA E PROJEKTIMIT (20104 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

A.2. Programi studimor: NDËRTIMTARI- KONSTRUKTIVE

1. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore MATEMATIKË (10900 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
2. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore KONSTRUKSION NDËRTIMOR NË NDËRTIMIN E ULËT DHE TË LARTË (20702 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
3. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore MATERIALE NDËRTIMORE (20700 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
4. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore FIZIKË (10300 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

A.3 Programi studimor: GJEODEZI DHE GJEONFORMATIKË

1. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore KADASTËR DHE OPERACIONET AGRARE (20603 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
2. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore GJEODEZI E ULËT (20600 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
3. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore MATEMATIKË (10900 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

B. Shpallet konkurs për zgjedhjen e mësimitdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore -shkencore dhe bashkëpunëtorë (asistentë - doktorantë) në Fakultetin e Shkencave të Informatikës në përbërje të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup

B.1 Programi studimor: INFORMATIKË –PROGRAMIMI

1. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore MATEMATIKË (10900 nga Klasifikimi i lëmive hulumtueso-shkencore, fushave dhe lëmive sipas Klasifikimit të Fraskatit)
2. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore ARKITEKTURA E SISTEMËVE LLOGARITËSE (21200 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
3. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore SISTEMET DHE INTELEGJENCA ARTIFICIALE (21205 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
4. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore LINGUISTIKA ANGLEZE (60404 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

B.2 Programi studimor: INFORMATIKË - ARSIMORE

1. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore MËSIMDHËNIA ME ZBATIMIN E KOMPJUTERIT (50514 nga Klasifikimi i lëmive hulumtueso-shkencore, fushave dhe lëmive sipas Klasifikimit të Fraskatit)
2. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore BAZA E TË DHËNAVE (21203 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

C. Shpallet konkurs për zgjedhjen e mësimitdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore -shkencore dhe bashkëpunëtorë (asistentë - doktorantë) në Fakultetin e shkencave teknike në përbërje të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup

C.1 Programi studimor: SISTEMET ELEKTROENERGJETIKE

1. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore FIZIKË (10300 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

2. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore ELEKTROENERGJETIKË (20201 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

C.2 Programi studimor: INXHINIERI MAKINERIKE DHE MENAXHMENT

1. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore ELEMENTE MAKINERIKE DHE SISTEMET TEKNIKE (21401 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
2. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore TJETER (INFORMATIKË) (11011 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

C.3 Programi studimor: INXHINIERIA E TRANSPORTIT DHE KOMUNIKACIONIT

1. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore PLANIFIKIMI DHE PROJEKTIMI URBAN DHE HAPËSINOR (20114 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
2. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore TJETËR - PROJEKT MENAXHMENT (50624 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
3. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore INXHINIERIA E TRANSPORTIT DHE PROJEKTIM (22012 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

C.4 Programi studimor: MEKATRONIKË

1. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore ELEKTROTEKNIKË (20200 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
2. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore TJETËR (MATERIALE) (21509 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

C.5 Programi studimor: INXHINIERIA EKONOMIKE

1. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore TJETËR (RREGULLIMI DHE MENAXHIMI ME PROCESIT TEKNOLOGJIKE) (218008 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
2. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore TEORIA E VENDIMARRJES (21109 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
3. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore STUDIUM I FAKTORËVE TË MJEDISIT TË PUNËS DHE SIGURISË NË PUNË (22507 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
4. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore NDËRMARRËSI (50623 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
5. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore LINGUISTIKË ANGLEZE (60404 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

C. Shpallet konkurs për zgjedhjen e mësimitdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore -shkencore dhe bashkëpunëtorë (asistentë - doktorantë) në Fakultetin e Shkencave Teknologjike në përbërje të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup.

Ç.1 Programi studimor: INXHINIERIA E MATERIALEVE DHE NANOTEKNOLOGJIVE

1. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore BIOINXHINIERIA (41300 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
2. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore KIMI (10700 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

Ç.2 Programi studimor: TEKNOLOGJIA USHQIMORE

1. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore INXHINIERIA USHQIMORE (41400 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
2. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore BIOLOGJI (10200 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

D. Shpallet konkurs për zgjedhjen e mësimitdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore -shkencore dhe bashkëpunëtorë (asistentë - doktorantë) në Fakultetin e Shkencave Sociale në përbërje të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup

D.1 Programi studimor: POLITIKA SOCIALE DHE PUNË SOCIALE

1. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore SHKRIM AKADEMIK (64029 TJETËR nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

2. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore SISTEMET E MBROJTJES SOCIALE (51204 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

D.2 Programi studimor: SPORT DHE SHKENCAT E SPORTIT

1. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore KINEZILOGJIA E APLIKUAR- (sport, edukatë fizike, rekreacion, kinezoterapi dhe të tjera)- (50401 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
2. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore KINEZILOGJIA FUNDAMENTALE (biomekanika, psikometrika, fiziologjia dhe të tjera)- (50400 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

D.3 Programi studimor: MEDIUMET DHE KOMUNIKIMI NDËRKULTUROR

1. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore SOCIOLINGUISTIKË (64015 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

D.4 Programi studimor: ADMINISTRATË PUBLIKE DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

1. Një mësimitdhënës nga fusha arsimore - shkencore MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE (50622 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)
2. Një bashkëpunëtor nga fusha arsimore - shkencore ADMINISTRATA DHE SHËRBIMET PUBLIKE (50901 nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore - hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit)

DH. Kandidatët e interesuar duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje arsimore - shkencore, respektivisht në thirrje për bashkëpunëtorë (asistentë - doktorantë) të përcaktuara me Ligjin për Arsimitin e Lartë.

E. Kandidatët për thirrje arsimore - shkencore mësimitdhënës duhet t'i dorëzojnë dokumentet që vijojnë:

- o Kërkesë për aplikim
- o Diploma e marrjes së titullit shkencor doktor i shkencave të lëmisë shkencore në të cilën zgjidhet (një ekzemplar i diplomës i notarizuar dhe tri kopje; diplomat e fituara jashtë vendit të jenë të nostrifikuara dhe të jenë me ekuivalencë të notave);
- o Biografi të shkurtë (në tri kopje);
- o Lista e punimeve të publikuara shkencore (një kopje e punimeve);
- o Një kopje e punimit të doktoraturës;
- o Vërtetim për zgjedhje në thirrjen mësimore-shkencore (nëse posedon);
- o Certifikata e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë.

F. Kandidatët për titullin bashkëpunëtorë (asistentë - doktorantë) duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- o Fletëparaqitje;
- o Diploma e marrjes së titullit shkencor Magjistër nga lëmia shkencore në të cilën zgjidhet (një ekzemplar i diplomës i notarizuar dhe tri kopje; diplomat e fituara jashtë vendit të jenë të nostrifikuara dhe të jenë me ekuivalencë të notave);
- o Biografi të shkurtë (në tri kopje);
- o Lista e punimeve të publikuara shkencore (një kopje e punimeve), në qoftë se i posedojnë;
- o Dëshmi për njohjen e gjuhës angleze, edhe atë: (TOEFEL) - më së paku 74 pikë për dhënien elektronike të provimit përmes kompjuterit, jo më të vjetër se dy vjet nga data e lëshimit, (IELTS) - më së paku 6 pikë, jo më i vjetër se dy vjet nga data e lëshimit, (TOLES) - njohuri bazike (Foundation level), (ILEC) - e kryer me së paku me sukses B2 dhe Certifikatë të Kembrixhit për anglishten preliminare (Certifikate of Preliminary English)(B1);
- o Certifikata e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë.

F. Për kandidatët të cilët do të paraqiten për t'u zgjedhur në thirrjen arsimore - shkencore docent, përveç dokumenteve të theksuara më sipër, duhet të paraqesin edhe dëshmi se kanë arritur notë mesatare më së paku 8.00 për çdo cikël studimor veçmas.

G. Për kandidatët të cilët do të paraqiten për zgjedhje në thirrje bashkëpunëtorë (asistent - doktorant), përveç dokumenteve më sipër të përmendura, duhet të paraqesin edhe dëshmi se kanë arritur notë mesatare më së paku 8.50, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve.

GJ. Konkursi zgjat dhjetë (10) ditë pune prej ditës së shpalljes së konkursit. Fletëparaqitjen me dokumentet e nevojshme, kandidatët duhet t'i dorëzojnë në hapësirat e Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, rr."12 Brigada e Maqedonisë" nr. 2-a /kati VII (me shënimin: Konkurs për mësimitdhënës në të gjitha thirrjet arsimore-shkencore dhe bashkëpunëtorë (asistentë - doktorantë) të:

- A. Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës
- B. Fakulteti i Shkencave të Informatikës
- C. Fakulteti i Shkencave Teknike
- D. Fakulteti i Shkencave Teknologjike
- E. Fakulteti i Shkencave Sociale në përbërje të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup

KOMUNA E BUTELIT
KRYETARI I KOMUNËS
Nr. . 09-906/2 më datë 01.08.2017
Shkup

Në bazë të nenit 35, ndërsa në lidhje me nenin 51 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016 dhe 163/2016), Kryetari i Komunës Butel në vijim publikon këtë:

KUMTESË

Informohen qytetarët dhe subjektet juridike se Kryetari i Komunës së Butelit ka sjellë Vendim për organizim të:

PREZANTIMIT PUBLIK DHE ANKETËS PUBLIKE

Për Projektin arkitektonik-urbanistik për ndërtim të terrenit për prodhim me depo dhe përmbytje shoqëruese në PK 1029/1, KK Vizbeg, Blloku 5, PUJVB për Zonën industriale Vizbeg /Përpunim të bllokut 12/, KK Vizbeg, Komuna Butel, Shkup

Hapësira e definuar për përpilim të Projektit arkitektonik-urbanistik për ndërtim të terrenit për prodhim me depo dhe përmbytje shoqëruese në PK 1029/1, KK Vizbeg, nga Plani urbanistik jashtë vendbanimit për zonë industriale – Vizbeg” – me përpunim të Bllokut-12-KK Vizbeg, komuna e Butelit, me grup të klasës së qëllimit G – prodhim, distribuim dhe shërbime, gjegjësisht klasa themelore e qëllimit – industria e lehtë dhe jo helmuese – G2 (teren prodhues me depo dhe përmbytje shoqëruese), me pozitën e vet ndodhet në territorin e Komunës Butel.

Përfshirja projektuese që është lëndë e këtij dokumentacioni projektues, kapë hapësirë prej 3.796,91 (0,38 ha).

area 3796.91	at point X=7533144.92 Y=4654623.63	at point X=7533056.60 Y=4654580.71
perimeter 285.51	at point X=7533148.65 Y=4654617.24	at point X=7533029.87 Y=4654604.51
at point X=7533130.96 Y=4654650.84	at point X=7533058.67 Y=4654578.93	at point X=7533103.74 Y=4654638.36
at point X=7533138.03 Y=4654635.93	at point X=7533058.67 Y=4654578.93	at point X=7533130.96 Y=4654650.84

Projekti i përpiluar arkitektonik-urbanistik me shtojcat grafike do të ekspozohet në vend publik lokalet e Komunës së Butelit në Sallën për takime (Salla e vogël).

Anketa publike do të mbahet prej më 08.08.2017 deri më 14.08.2017 (pesë ditë pune), çdo ditë pune prej ora 08.30 deri në ora 15.30 në lokalet e Komunës së Butelit në Sallën për takime (Salla e vogël).

Në afatin e caktuar subjektet e interesuara fizike dhe juridike mund të dorëzojnë vërejtje në listat anketuese në formë elektronike përmes sistemit informatik e-urbanizam ose me formë me shkrim.

Listat anketuese për pjesëmarrje në Anketën publike mund të merren në Komunën e Butelit (sportel).

Kumtesa për organizim të anketës publike është publikuar në Gazetat ditore Veçer dhe Koha, në sistemin informativ e-urbanizam dhe në ueb faqen e Komunës së Butelit.

Prezantimi publik në lidhje me Projektin arkitektonik-urbanistik për ndërtim të terrenit për prodhim me depo dhe përmbytje shoqëruese në PK 1029/1, KK Vizbeg, Blloku 5, PUJVB për Zonën industriale Vizbeg /Përpunim të bllokut 12/, KK Vizbeg, Komuna Butel, Shkup, do të mbahet në lokalet e Komunës së Butelit, në Sallën për takime (Salla e vogël), më datë 10.08.2017 me fillim në ora 10:00.

KRYETARI I KOMUNËS SË BUTELIT
Petre Llatinovski

Në bazë të nenit 37 nga Ligji për arsim profesional dhe trajnim (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 71/06, 117/08, 148/09, 17/11, 24/13, 137/13, 41/14, 145/15 dhe 55/16) dhe neni 18 nga Rregullorja për llojet e kontributeve autoriale dhe shërbimeve tjera intelektuale dhe kriterëve, mënyra e përzgjedhjes, shuma e kompensimeve autoriale dhe numri i anëtarëve në ekipet profesionale të Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnim nr. 01-401/10 dhe 01-1028/12 dhe 01-977/15, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim – Shkup, shpall:

KONKURS

për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm për punë profesionale për nevojat e Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnim – Shkup

1. Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim – Shkup, shpall konkurs për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm për këto punë profesionale:

1.1 Një (1) mësimdhënës nga shkolla e mesme profesionale nga drejtimi përkatës për përpilimin e standardeve të profesionit dhe dy (2) mësimdhënës nga shkolla e mesme profesionale nga drejtimi përkatës dhe një (1) profesor universitar nga drejtimi përkatës për përpilimin e standardeve të kualifikimit, edhe atë:

A) Drejtimi/sektori: Gjeologji, Miniera dhe Metalurgji

• **Standard i profesionit:** Operator për kërkime gjeoteknike dhe hidrogeologjike; Operator për kërkime të lëndëve të para minerale, Operator i minierave për eksploatinim mbitokësor dhe nëntokësor; Operator i minierave për përgatitjen e lëndëve të para minerale; Operator për shpim dhe minim; Operator i pajisjeve dhe stabilimenteve metalurgjike për prodhim (hekur, çelik, ferrolidhje, copë e derdhur, metale të ngjyroshura); Operator i pajisjeve për ngjeshje dhe presim dhe përpunim termik.

• **Standard i kualifikimit me plan mësimor:** teknik i gjeologjisë dhe minierave; teknik i metalurgjisë.

B) Drejtimi/sektori: Kimi dhe Teknologji

• **Standard i profesionit:** Operator në industrinë organike-polimere; Operator në industrinë kozmetike; Operator në industrinë farmaceutike; Operator industrinë e detergjenteve; Kontrollor i mbetjeve dhe materieve të rrezikshme; Kontrollor i emisioneve të gazrave nga burimet stacionare; Kontrollor i cilësisë së produkteve dhe materialeve; Operator për analiza mikrobiologjike dhe sanitare; Kontrollor i cilësisë së ujit; Operator i procesit; Manipulator me makina për ambalazhim, paketim dhe etiketim; Përpunues i pemëve dhe perimeve; Prodhues i pijeve alkoolike dhe joalkoolike; Përpunues i miellit – Mullixhi; Prodhues i produkteve konditore/Konditor; Prodhues i birrës, uthullës dhe majës (tharmit); Prodhues i ushqimit të shëndetshëm; Prodhues i ushqimit dietal; Përpunues i kafesë, çajeve dhe mëlmesave për ushqim; Operator në industrinë agrokimike; Operator në industrinë joorganike; Prodhues i EKO ambalazhit; Operator i karburanteve;

• **Standard i kualifikimit me plan mësimor:** Teknik laboratorik; Teknik për kontroll të proceseve prodhuese; Teknik ekologjik; Teknik ushqimor; Teknik për teknologji kimike, kozmetike dhe farmaceutike.

1.2 Një (1) mësimdhënës nga shkolla e mesme profesionale nga drejtimi përkatës dhe një (1) profesor universitar nga drejtimi përkatës për përpilimin e programeve mësimore, edhe atë:

C) Drejtimi/ sektori: Hoteleri dhe Turizëm – Kualifikim (profil arsimor): teknik i hotelerisë dhe turizmit

• **Programe mësimore:** Bazat e turizmit – viti i parë; Bazat e hotelerisë – viti i parë; Ekonomia e turizmit – viti i dytë; Marketing në turizëm - viti i tretë; Sipërmarrësi dhe inovacione – viti i katërt; Komunikimi afarist – viti i parë; Psikologjia në turizëm – viti i tretë; Puna në agjenci – viti i dytë, tretë dhe katërt; Puna në hotele – viti i dytë, tretë dhe katërt; Sisteme informatike në hoteleri dhe turizëm – viti i dytë; Higjiena dhe ekologjia – viti i parë; Trashëgimia kulturore dhe historike – viti i dytë; Destinacionet turistike – viti i katërt; Format alternative të turizmit – viti i tretë; Gjuhë e huaj II- viti i tretë dhe katërt; Animacione në turizëm –viti i tretë; Udhëheqje turistike – viti i katërt; Uelnes dhe SPA – viti i tretë; Menaxhimi i evenimenteve – viti i katërt; Zhvillim i qëndrueshëm i turizmit – viti i katërt; Bazat e shërbimeve hotelerie – viti i tretë; Bazat e gastronomisë – viti i katërt.

Ç) Drejtimi/sektori: Ndërtimtari dhe Gjeodezi – Kualifikim (profil arsimor): Teknik ndërtimtarie

• **Programe mësimore:** Ndërtimtari, gjeodezi dhe sektorë tjerë ekonomik – viti i parë; Vizatim teknik me komunikim kompjuterik – viti i parë; Gjeometria deskriptive - viti i parë; Planifikim dhe menaxhment

- Viti i tretë; Normimi dhe planifikimi me zbatim të TIK-ut - viti i katërt; Mekanika teknike – viti i dytë; Konstruksionet e betonit të armuar –viti i tretë; Konstruksionet e çelikut – viti i katërt; Rezistenca e materialeve – viti i tretë; Urat dhe trarët nga betoni i armuar – viti i katërt; Rugët – viti i tretë; Hekurudhat – viti i katërt; Bazat e gjeoteknikës dhe hidroteknikës – viti i dytë; Objektet hidroteknike – viti i tretë; Ujësjiellësi dhe kanalizimi – viti i katërt; Teknologjia e betonit – viti i dytë; Materiale ndërtimore dhe konstruksione – viti i dytë; Efikasiteti energjetik dhe mbrojtja nga zjarri i objekteve ndërtimore – viti i tretë dhe katërt; Planifikim dhe menaxhment në ndërtimtari – viti i tretë dhe katërt; Zbatimi i konstruksioneve nga betoni i armuar në ndërtimtari – viti i tretë dhe katërt; Vija komunikacioni – viti i tretë dhe katërt; Zbatimi i hidro-ndërtimit - viti i tretë dhe katërt.

D) Drejtimi/sektori: Elektroteknikë – Kualifikim (profil arsimor): Elektroteknik për teknikë kompjuterike dhe automatikë

• **Programe mësimore:** Elektroteknikë – viti i parë dhe i dytë; Materiale elektroteknike – viti i parë; Komunikimi teknik – viti i parë; Teknologjitë bashkëkohore të sektorëve ekonomik në tregun e punës – viti i parë; Matje elektrike – viti i dytë; Elektronikë – viti i dytë; Qarqe logjike – viti i dytë; Bazat e sistemeve digjitale – viti i tretë; Mikroprocesorë dhe mikrokontrollorë – viti i katërt; Bazat e programimit – viti i dytë; Programimi i orientuar i objektit – viti i tretë; Bazat e të dhënave – viti i katërt; Mikro-kompjuterë dhe programimi i tyre – viti i dytë; Sisteme për drejtim automatik – viti i tretë; Drejtim i proceseve – viti i tretë; Robotikë – viti i katërt; Dizajnimi i ueb faqeve – viti i tretë; Sisteme kompjuterike dhe rrjete – viti i katërt; Sisteme të automatizuara - viti i tretë; Multimedia – viti i tretë; ueb programimi – viti i tretë; Efikasiteti energjetik i objekteve – viti i katërt; Modelimi 3D – viti i katërt; Gjuhët programore – viti i katërt.

2. Të drejtë konkurrimi kanë: mësimdhënës nga shkollat e mesme të cilët i plotësojnë këto kushte:

-të kenë së paku tre vjet përvojë pune në arsimin profesional nga drejtimi përkatës, dhe profesorët universitar të cilët i plotësojnë këto kushte: -të kenë publikuar artikuj shkencor, respektivisht kontribute shkencore të cilat janë të rëndësishme për drejtimin përkatës dhe për përparimin e arsimit dhe edukimit. Me kandidatin i cili i plotëson kushtet dhe do të përzgjidhet si bashkëpunëtor i jashtëm do të nënshkruhet kontratë. Kandidati duhet të paraqes fletëparaqitje ku qartë duhet të shkruajë pozitën për të cilën paraqitet, gjithashtu duhet të dorëzojë dokumentacionin për plotësimin e kushteve të cilat janë përmendur në këtë konkurs (vërtetim që është në marrëdhënie pune) dhe biografi të shkurtë. Nuk do të shqyrtohen fletëparaqitjet të cilat nuk janë të kompletuara dhe nuk janë të dorëzuara me kohë. Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e shpalljes. Fletëparaqitjet me dokumentacionin e duhur dorëzohen në arkivin e Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnim, ose nëpërmjet postës në adresën Bul. Goce Dellçev nr:18 – Shkup, p.fax290.

Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim - Shkup

ENVER SELIMI, PIKTOR



ARTI, ZANAT QË NUK PËRFUNDON KURRË



Arti të jep aq shumë hapësirë dhe mundësi të lëvrosh e hulumtosh duke ndjekur të bukurën saqë e flasim suksesshëm realitetin... Nuk dua të them se neve nuk na lëndon antihumanizmi, pabarazia sociale, injoranca dhe zemër ngurtësia e politikëbërësve apo kapriçot e pasanikëve të çastit. Përkundrazi, shpirtërisht lëndohemi shumë, sepse ne krijojmë me shpirt dhe emocion. Përparësia jonë është se ne futemi në botën tonë artistike, duke ndjekur "gjahun" tonë artistik në mënyrë që të shprehim qoftë gëzimin apo dëshpërimin

Koha

Delvina KËRLUKU

Enver SELIMI u lind më 1977 në Tetovë. Kreu Fakultetin e Artit Figurativ, dega grafikë te profesor Fatmir Kripa në Tetovë. Magjistroi po ashtu në grafikë te profesor Trajçe Bllazhevski, në Shkup. Realizoi pesë ekspozita personale në Tetovë, Shkup dhe Prizren. Ka marrë pjesë në disa ekspozita kolektive në Tetovë, Gostivar, Kumanovë, Shkup, Prishtinë, Bruksel, Korçë, Novi Pazar, Berlin, etj. Po ashtu ka marrë pjesë në disa bienale dhe trienale në Tetovë, Sofje dhe Manastir, koloni artistike në vend dhe jashtë vendit. Është anëtar i shoqatës së artistëve figurative në Tetovë. Posedon galeri private 'Art Décor' në Tetovë, punon 13 vite si profesor në gjimnazin e Tetovës, rregullisht merret me murale, kryesisht të ndërtesave, xhamive, çerdheve, lokaleve, dhomave etj.

KOHA: Në pikturat tuaja pasqyrohet një ujë i kulluar, ku përtej shihen shenja gjurme, qoftë ngjyrë e zezë, qoftë ngjyrë e kuqe. Ç'simbol është ky?

SELIMI: Për pikturin, pos tjera-sh, ngjyrat janë mjet pune. Janë fjalë, janë emocione, qortim, dashuri, zemërim..., janë gjithçka me anë të të cilave piktori shpreh brendinë e tij artistike, është mënyra se si ai komunikon me artdashësit. Artistët në përgjithësi kanë një horizont skajshmërisht të largët e të gjerë. Botëkuptimi i tyre shpeshherë nuk përkon me realitetin dhe detyrimisht që ngjyra blu pasqyron botën e tij të pafundme dhe lirinë absolute shpirtërore, e pastaj ngjyrat tjera janë pjesë përbërëse apo pjesëzat që plotësojnë mozaikun, varësisht nga momenti i krijimit dhe mesazhi i pikturit.

KOHA: Pikturë tjetër, që në syrin e një gjeografi paraqet

tokën e mbuluar me ujë, në syrin e një kongresmeni duket një tryezë e rrumbullakët, nga pjesëmarrës të vendeve të botës, për diskutim, në syrin e shkrimtarëve një shpirt i dalë nga trupi i tij. Në syrin e piktorit ç'shihet?

SELIMI: Jo domosdoshmërisht uji paraqet oqean, qiell apo diçka tjetër që prek dhe sheh syri i njeriut. Për piktorin uji është ndonjëherë sinonim i një shpirti të lirë, herë i qetë e herë i vrullshëm, që noton brigueve andej e këndej për të gjetur qetësinë apo për të prishur rutinën duke kërkuar sfida të reja. Nganjëherë shpreh dhimbje apo nostalgji, dashuri, nganjëherë shpreh kapriçot e piktorit për të paraqitur një panoramë abstrakte që të len vrojtuesin e lirë që të nojtojë brenda pikturës.

KOHA: Si nisi karriera juaj në pikturë. Ishte vet dëshirë, e trashëguar apo e imponuar dhe me kohë, punë e zotëruar?

SELIMI: Arti me veçantinë e tij është një "zanat" që nuk mund të imponohet në asnjë mënyrë, nëse nuk ke talent. Për fatin e mirë ky talent dhurohet nga Perëndia dhe ata që kanë fatin ta zotërojnë këtë talent, janë të uruar..., por sigurisht që nuk mjafton vetëm talenti por, duhet dhe shumë punë e investim që një piktor të gjej veten, stilin dhe degën ku do të gravitojë. Me një fjalë unë këtë profesion nuk e kam të imponuar assesi por thjesht është përzgjedhja ime me të cilën jam shumë i lidhur dhe i nderuar.

KOHA: Fëmijëria e piktorit shpesh pasqyrohet në veprat e tij? Si e përshkruani atë moshë?

SELIMI: Fëmijëria ime është shumë e larmishme, plot ngjyra..., ashtu si çdo kush edhe unë kujtime më të ëmbla dhe më të çiltërta i kam nga ajo moshë. Kam pasur fatin që të rrethohem nga një gjiri familjar shumë i këndshëm dhe shoqëror. Zakonisht kam qenë natyrë e qetë në dukje, por që brenda meje kisha "vullkan" ndjenjash e emocionesh të paqarta për moshën. Edhe kur akoma se kisha kuptuar se do bëhesha piktor unë për çdo gjë apo ngjarje kisha të vërtetën time. Ndoshte që edhe një dialog i shkurtër më krijonte dramë të madhe shpirtërore, meditime e perceptime joreale. Nuk e di, mbase energjia që gëlonte brenda meje më jepte pasqyrimë të veçanta. Asnjëherë nuk vendosja pikë për asgjë. Pastaj me kalimin e kohës, kur fillova të praktikoj artin gjithë atë energji, gjitha ato pasqyrimë i shprehja në letër e më vonë në pëlhurë duke luajtur me ngjyra e forma të ndryshme varësisht se çfarë doja të thosha dhe të përcillja tek vrojtuesi.

KOHA: Cila është piktura e jetës tuaj?

SELIMI: Është vobektësi profesionale për një piktor profesionist që mëton shumë e me shumë për të





dhënë e të thotë se e kam bërë vepërën e jetës. Unë kam punuar shumë si në pikturë, vizatim, grafikë, portrete, punoj edhe murale me shokët e mi dhe në të shumtën e rasteve jam i kënaqur me punën e bërë, duke u bazuar në vizitat e ekspozitave të mia dhe kritikën artistike, por gjithsesi mendoj se akoma nuk e kam dhënë maksimumin tim nga vetja. Kam shumë art për të dhuruar... Arti është një fushë e gjerë që të lejon të hulumtosh e manipulosh me stile e ngjyra deri në gjetjen e asaj që kërkon, por në të njëjtën kohë është zanat që nuk përfundon kurrë së mësuarit e zbuluarit teknika e mënyra të reja veprimi. Prandaj po them se akoma jam rrugës për vepërën e jetës.

KOHA: Frymëzimet për të pikturuar i gjeni nga jeta e përditshme, nga natyra, nga fatkeqësitë natyrore, nga lufta dhe dukuri tjera?

SELIMI: Të them se frymëzimi më vjen nga kjo apo ajo do isha shumë i kufizuar. Artistët bëjnë diferencën pikërisht sepse frymëzohen nga gjithçka dhe në çdo situatë. Nganjëherë një fragment i pakëndshëm të ngacmon sa një skenë lufte. Ngacmohesh artistikisht sa që të intrigon që gjithë mllëfin dhe indinjatën ta shfaqësh në pikturë. Ndothë që edhe një petale luleje të të mbush me frymëzim që simbolizon dashuri, gëzim, të mbush me emocion deri në ekstazë, sa që detyrimisht kjo energji pozitive përfundon në një vepër arti që përçon vetëm mirësi tek syri i njeriut. Nuk mund të di dhe ta përcaktoj frymëzimin, thjesht është gjithmonë prezent dhe në kërkim të të veçantës, pret shpërthimin artistik në momentin e duhur.

KOHA: Arti, piktura dhe shkencën është dashuria dhe ideali jetësor. Edhe pse keni lindur për art dhe jetoni për artin, në vendin tonë të jesh piktor nuk është lehtë, por është sakrificë?

SELIMI: Në fakt është e vërtetë

se unë jetoj me artin, sepse më shumë se profesion e kam pasion. Thjeshtë është mënyrë jetese për mua. Them kështu sepse arti është ajo forcë brenda meje që edhe nga detajet jep gjëra të mëdha. Në çdo situatë qoftë e pakëndshme, e lumtur, qoftë duke pushuar apo qoftë edhe nga në ëndërr ngacmohesh artistikisht për të krijuar. Pra arti është gjithnjë në veprim. Gjithë kjo të krijon një satisfaksion të papërshkrueshëm sepse energjia që është brenda teje asnjëherë nuk të lejon të prekësh monotoninë. Kjo që thash ka të bëjë me shpirtëroren dhe kënaqësinë që të jep arti yt, ndërsa kur flasim për anën materiale nuk mund të them se arti të bën jetën më të lehtë ekonomikisht, ashtu si çdo profesion tjetër në këtë nënqiejll. Kur jemi te ajo se sa njerëzit e çmojnë artin dhe artistin mund të them se është një situatë e kënaqshme, solide. Problemi është se akoma për shumicën absolute të popullatës, blerja e një pikturë është një luks i tepruar sepse të ardhurat i kanë përtej çdo mundësie reale për të investuar në pikturë. Prandaj po them se njerëzit e kuptojnë e duan dhe e çmojnë artin por, mundësia për ta prekur është e vogël.

KOHA: Sa kanë rëndësi ekspozitat në jetën e një piktori?

SELIMI: Ekspozitat për piktorin janë si një vitrinë ku ai shpalos krijimtarinë e tij, që janë jetike në fillimet e çdo piktori. E rëndësishme është që piktori të mbahet gjallë vazhdimisht me punimet e tij dhe sigurisht që në këto ekspozita mjaft i rëndësishëm është pëlqimi nga publiku dhe kritika artistike. Më pas kur piktori të arrijë një afirmim solid dhe pjekuri profesionale, ekspozitat duhet që të përçojnë një mesazh të caktuar apo të ndjekin një mision të mirëfilltë dhe serioz sepse, përndryshe nuk do dallonin nga vitrinat e dyqaneve.

KOHA: Cili është rrugëtimi juaj drejt botës së artit pra, shkolla, mësuesit, kolegët, etj?

SELIMI: Rrugëtimi im drejt botës së artit është shumë i hershëm, më herët se sa unë isha në gjendje ta kuptoja talentin tim. Më pas kur prindërit nuhatën talentin dhe dashurinë time për artin figurativ më udhëzuan që të ndjek nga afër dy profesorët e nderuar tetovarë, Mihtar Memeti dhe Nehat Beqiri dhe njëkohësisht të marr udhëzime dhe leksione nga ta. Pata fatin që t'i kem profesorë në shkollë të mesme dhe në fakultet. Më pas në studimet universitare përveç profesorëve dhe piktorëve të nderuar tetovarë që i përmenda më lartë i gjithë stafi akademik ishte i importuar nga universiteti i Prishtinës. Profesorët të njohur, piktorët të dëshmuar punonin me ne. Aq sa ishte vështirë të punoja me ta në të njëjtën kohë ishte kënaqësi dhe privilegj gjithsesi një motiv i pashtershëm për të përvetësuar gjithçka mundeshim, bile dhe përtej mundësive reale. Ndërsa, studimet posuniversitare i kam kryer në Shkup në universitetin "Shën Kirili dhe Metodij". Sa i takon relatave me kolegë lirisht mund të them se thuajse i gjithë spektri i rrethit tim shoqëror i takon botës së artit. Kështu që, me plot mburrje mund të them se kolegët dhe profesorët e mi sot janë miqtë e mi më të mirë.

KOHA: Ka shumë piktorë që njeh historia e artit dhe që kanë dhënë përkushtim të madh në kulturën botërore. Cili është piktori që pëlqeni. Stili Juaj a përputhet me mënyrën se si e shpreh mendimin dikush tjetër, në pikturë?


SELIMI: Sigurisht që ka mjaft piktorë botëror që kanë lënë gjurmë dhe që akoma janë dhe do jenë model për gjeneratat në vijim. Fama e tyre është e përvetshme dhe vështirë se mund të kapen nga të tjerë. Unë si fëmijë, natyrisht në një moshë të njomë 7-8 vjeç, jo se ndiqja apo frymëzohesha nga ndonjë emër i spikatur por vizatoja "ëndrrat e mia" fëmijërore, në mënyrën time. Gradualisht duke e njohur botën e artit figurativ në përgjithësi, fillova të ndërtoj botëkuptimin tim dhe stilin që pa dashje e kam ndjekur e që përkon të ngjasojë apo të klasifikohet në stilet e njohura dhe të dëshmuara në botën e artit. Prandaj pa hezitim mund të them se natyra ime e krijimit përfaqon stilet si realizmin, ekspresionizmin, barokun, abstraksionin sigurisht piktorët që gravitojnë në këto stile siç janë Rembranti, Van Gogu, Kandinski apo e kisha përmendur një piktor anglez që ende jeton Colin Davidson dhe shumë të tjerë, janë edhe udhërrëfyesit e mi se si të arrij majat në profesion.

KOHA: Ne kemi nevojë që në lakun e kohës të kapemi të gjithë si shoqëri, që të mësojmë të dalim nga ishulli ku jetojmë, nga izolimi social dhe llogaria anti humane, ku jemi pozicionuar. Si e shihni botën e artistit, me miq apo në një vetmi të thellë. Pse?

SELIMI: Shpresoj mos të tingëllojë si prepotent, por pikërisht bota e artistit në të shumtën e rasteve është më e avancuar shpirtërisht se sa e të tjerëve, prandaj përsëri po them se artistët bëjnë diferencën. Arti të jep aq shumë hapësirë dhe mundësi të lëvrosh e hulumtosh duke ndjekur të bukurën sa që e flasim suksesshëm realitetin... Nuk dua të them se neve nuk na lëndon antihumanizmi, pabarazia sociale, injoranca dhe zemër ngurtësia e politikëbërësve apo kapriçot e pasanikëve të çastit. Përkundrazi, shpirtërisht lëndohemi shumë, sepse ne krijojmë me shpirt dhe emocion. Përparësia jonë është se ne futemi në botën tonë artistike, duke ndjekur "gjahun" tonë artistik në mënyrë që të shprehim qoftë gëzimin apo dëshpërimin. Edhe pse mund të përjetojmë dhimbje arrijmë që tërë atë energji negative dhe mlllef ta kanalizojmë në një vepër arti me mesazh domethënës. Unë zakonisht jam i rrethuar me miq, por çasti i krijimit të diçkaje kërkon një "izolim" nga zhurmat e zakonshme (sa që e flakim suksesshëm realitetin...)

Me një fjale si Enver jam mjaft i rrethuar me miq e familjar por, momenti i krijimit është i rezervuar vetëm për mua dhe brushën time.

KOHA: Ëndrrat nuk bëhen realitet për të gjithë, por vetëm për ata që kanë qenë aq largpamës, sa të jenë të rreshtuar





Miratohet nisma për anëtarësim të Kosovës në INTERPOL

Në mbledhjen e fundit të Qeverisë është miratuar në parim nisma për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL. Zëvendësministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Behar Selimi ka thënë se kjo nismë për anëtarësim në këtë organizatë ndërkombëtare ofron mundësi të mëdha për

bashkëpunim të Kosovës me shtetet e tjera si dhe ndihmon në parandalimin e kriminimit dhe luftimin e formave të ndryshme të kriminalitetit. Në ndërkohë që po në këtë mbledhje, ministri në detyrë i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj ka thënë se janë marrë të gjitha masat që Kosova të

ketë mbështetjen e shteteve anëtare për anëtarësim në INTERPOL në votimin e Asamblesë së Përgjithshme në shtator. "Kemi marrë të gjitha masat e nevojshme që të sigurojmë mbështetje prej shteteve anëtare, prej 190 shteteve, duhet mbështetja e 110 shteteve që Koso-

va të mund të bëhet anëtare e INTERPOL-it", ka thënë Hoxhaj. Ai ka treguar edhe përfitimet e Kosovës në rast se ndodh anëtarësimi në këtë organizatë ndërkombëtare. "Gjëja më e rëndësishme do të ishte qasja e Policisë së Kosovës në të dhënat e INTERPOL-it dhe do të

kishim një mundësi që INTERPOL-i në të ardhmen të mos keqpërdoret siç është keqpërdorur nga Serbia. Ka shumë shtete që nuk e kanë njohur Kosovën por që kanë treguar vullnet që ta përkrahin anëtarësimin", ka thënë ministri Hoxhaj. Në ndërkohë, Ministri në

detyrë i Punëve të Brendshme, Skender Hyseni, ka udhëtuar për një vizitë pune në Amerikë ku do të takohet me Përfaqësues të Përhershëm të disa shteteve anëtare të OKB-së me fokus sigurimin e përkrahjes për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL.

S'ka më martesë të detyruar me përdhunuesin

Pjesa e kontestuar e amnistisë për përdhunuesin ka ndarë njerëzit, dhe përgjatë dekadave ka shkaktuar probleme të shumta humanitare dhe shoqërore

Dhoma e Ulët e Parlamentit në Jordani, votoi mbrëmë për shfuqizimin e një pjesë të diskutueshme të Kodit Penal i cili ka shfaqësuar përdhunuesit në rast se gjykata pajtohet që ai të martojë viktimën e tij, raporton Anadolu Agency (AA). Dhoma e Përfaqësuesve të Parlamentit të Jordanisë, me shumicë votash miratoi propozimin e qeverisë më të cilin shfuqizohet neni 308 i Kodit Penal, ndërkohë që në seancë ishte i pranishëm edhe kryeministri i Jordanisë, Hani al-Maliqi. Bëhet fjalë për një dispozitë ligjore që është në fuqi në Jordani që nga viti 1960, dhe me të, autori mund të shmang dënimin nëse pranon të martohet me viktimën e tij, dhe të qëndrojë i martuar për së paku pesë vite. "Qeveria mbetet e përkushtuar në përpjekjen e saj për të shfuqizuar pjesën e kontestueshme të Kodit Penal dhe të vazhdojë së forcuari sistemin e mbrojtjes së familjes në Jordani", tha kryeministri al-Maliqi. Kreu i Sindikatës së avokatëve jordanezë, Mazen Arshidat nga ana e tij tha se pjesa e kontestuar e amnistisë për përdhunuesin ka ndarë njerëzit, dhe përgjatë dekadave ka shkaktuar probleme të shumta humanitare dhe shoqërore. Projekt vendimi për heqjen e dispozitave kontestuese të Kodit Penal sot pritet të miratohet nga Senati, ndërsa fjalën e fundit e ka mbreti i Jordanisë, Abdullah II.

Qeveria turke planifikon t'u japë myftinjve të drejtën për të lidhur martesë. Organizatat e grave paralajmërojnë protesta

Që pas futjes në përdorim të Kodit Civil në vitin 1926, martesat në Turqi mund të lidhen vetëm përpara nëpunësit të gjendjes civile. Certifikata zyrtare e martesës ishte po ashtu kusht për lidhjen e martesës në xhami apo në një institucion tjetër fetar. Çiftet që nuk martoheshin në gjendjen civile, por vetëm përpara përfaqësuesit të fesë dënoshin me dy deri në

gjashtë muaj burg. Por dy vjet më parë Gjykata Kushtetuese e hoqi kushtin që për të lidhur martesë në një institucion fetar duhej përpara të ishte martuar në gjendjen civile, me arsyetimin se martesat para një kleriku nuk janë në kundërshtim me parimet e së drejtës penale. Tani qeveria turke po shkon një hap më tej. Sipas legjislationit të ri, autoritetet lokale fetare, pra myftinjët, do të kenë të drejtë të lidhin martesë që janë ligjrisht të vlefshme si ato të lidhura në zyrat e

gjendjes civile. Parlamenti pritet të votojë për ligjin pas pushimeve të verës. Por meqë partia islamiko-konservatore AKP ka në parlament shumicën dhe mbështetjet edhe nga partia nacionaliste MHP ligji mund të miratohet pa debate. Partia më e madhe opozicionare CHP, që konsiderohet si mbrojtëse e laicizimit në Turqi, është kundër këtij ligji. Edhe partia kurde HDP është kundër dhe e sheh këtë ligj si përpjekje të AKP-së për të futur në përdorim ligje anti-laike të bazuara



në rregulla islamike. Ministri i Drejtësisë Bekir Bozdog, tha se ligji nuk bie në kundërshtim me parimin e laicizimit dhe se me

Pence në Podgoricë

"Vizita e shekullit", një mesazh adresuar Moskës



madhe e organizuar ndonjëherë në Malin e Zi. Përgatitjet për pritjen e zëvendës-presidentit kanë zgjatur dy muaj. "Vizita e zëvendës-presidentit perceptohet si një shlyerje borxhi ndaj Malit të Zi, pas arritjeve të rezultateve shumë të vlefshme në aspektin e zhvillimit politik me referendum", thotë për DW Ivan Vukovic profesor në Fakultetin e Shkencave Politike në Podgoricë. Gazetari i së përditshmes "Vijesti" Divan Muric mendon, se nuk do të ketë diçka të re për të infor-

muar, sepse siç thotë ai: "Ne do të marrim vetëm informacione që janë të protokolluara nga ata. Do të përsëriten mesazhet, se Mali i Zi është tani një aleat i SHBA-së, dhe se Mali i Zi është në rrugë të qartë drejt Perëndimit". Ajo për çka me siguri nuk do të flitet, por në mënyrë të dukshme do të bëhet e qartë, është mesazhi në adresë të Rusisë. Pence vjen në Mal të Zi nga Gerorgjia, turneun evropian ai e nisi më 30 korrik me vizitën në Estoni. "Ky turne mund të interpreto-

het si një mesazh për Rusinë. Është e mjaftueshme të shihet vetëm agenda e vizitave: Estonia, Gjerorgjia dhe Mali i Zi, vende që duan të largohen nga ndikimi i Rusisë dhe vende që duan sigurinë se Shtetet e Bashkuara i mbështesin ato", thotë Muric për DW. Me këtë pajtohjet edhe politologu Vukovic: "Turi Evropian i Pence mund të shihet si një lloj manovrimi gjeopolitik për të kujtuar Moskën se sjellja e tyre agresive në arenën ndërkombëtare nuk është e pakufizuar".

Veseli nuk është kandidati final për kryeparlamentar

Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka zbuluar se Kadri Veseli nuk është kandidati final i PAN-it për kryetar të Kuvendit. Sipas Krasniqit, përkundër faktit se

Veseli është kandidati më i përshtatshëm për këtë pozitë, vetëm të enjten do të merret vesh kush nga koalicioni PAN do të kandidohet. Megjithatë, ai ka thënë se cilido që do të jetë kandidati

i PAN-it, ai do të votohet për kryetar të Kuvendit. "Nuk e thash që Kadri Veseli do të jetë kandidati ynë final, megjithëse është i duhuri dhe ka mbështetjen e plotë të PDK-së. Ne shpresojmë që të

jetë ai mirëpo në politik asnjëherë nuk i dihet. Megjithatë, nesër do të konstituohet Kuvendi dhe kandidati i PAN-it do të zgjidhet për kryetar, këtë ua garantoj", ka thënë Krasniqi.

Martese para myftiut

sipas mendimit të tyre ligji i ri do të çojë në shtimin e martesave të të miturave dhe do t'u japë mundësi burrave të martohen më tepër se me një grua njëkohsisht. Ato mendojnë se myftinjët nuk do ta respektojnë ligjin për moshën minimale të martesës si dhe kushtin që personat duhet të jenë të pamartuar. Aktivistja për të drejtat e grave Gjylsime Kava dhe presidentja e shoqatave të grave Canan Gylyja e konsiderojnë miratimin e një ligji të tillë shtypje dhe poshtërim të grave. Organizatat për të drejtat e grave i kanë dërguar një letër presidentit Erdogan ku kërkojnë prapësimin e këtij ligji. (DW)

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – teksti i pastruar (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 167/2015)
Drejtori i NP Ujësllësi dhe kanalizimi – Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE Për pranim të punëtorëve për kohë të pacaktuar

Publikohet shpallje publike për themelim të marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar për vendet e punës në vijim:

I. Sektori “Kontabilitet, punë financiare, furnizime publike dhe komerciale”

1. Inkasant – 2 realizues - me arsim të mesëm të mbaruar: PMP – shkalla IV

Dokumentet e nevojshme:

1. Fletëparaqitje (Lutje)
2. Certifikatë/Diplomë për arsim të mbaruar
3. Biografi të shkurtë
4. Certifikatë të shtetësisë

KUSHTET E POSAÇME:

1. Orari ditor i punës prej ora 07:30-15:30.
2. Orari javor i punës 40 orë pune (prej ditës së hënë deri ditën e premte).
3. Paga bazë është:
- për vendin e punës . Inkasant – 20.158,00 denarë

Shpallja publike zgjat 5 (pesë) ditë pune llogaritur nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Përgjithshja do të bëhet në afta prej së paku 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga përfundimi i shpalljes.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit dhe i pakompletuar nuk do të merret parasysh.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm kandidatët duhet ti dorëzojnë në adresën rr. “Llazar Liçenoski” nr. 9 – Shkup.

Telefoni për kontakt 02/30 73 010 lok. 316; kontakt personi: Biljana Ivanovska;

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pika 2 e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/141, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), IP Qendra ndërkomunale për punë sociale të Qytetit të Shkupit publikon:

SHPALLJE PUBLIKE Për punësim të 6 (gjashtë) realizuesve për kohë të caktuar me kohëzgjatje deri më 31.07.2017 në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale të Qytetit të Shkupit

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale të Qytetit të Shkupit publikon shpallje për punësim të 6 (gjashtë) realizuesve për kohë të caktuar për pozitën në vijim:
1. Punëtor i diplomuar social të nivelit A5 në Shërbimin për të drejtat e ndihmës në të holla – 3 realizues
2. Punëtor i diplomuar social të nivelit A6 në Shërbimin për të drejtat e ndihmës në të holla – 3 realizues

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale të Qytetit të Shkupit (për të gjithë kandidatët):
Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
Në mënyrë aktive të njëj gjuhën maqedonase;
Të jetë i moshës së rritur;
Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale e Qytetit të Shkupit për vendin e punës me numër rendor 1 të kenë të arritura 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit dhe së paku dy vjet përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale (dëshmi për përvojën e punës).
Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.
Njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombtarisht e të lëshuar nga testatorët oficalë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A1 të CEFR, përkatësisht BULATS ose Apts; ose TOEFL PBT së paku 310 pikë, TOEFL CBT së paku 35 pikë, ose TOEFL IBT së paku 10 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale e Qytetit të Shkupit për vendin e punës me numër rendor 2 të kenë të arritura 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit dhe pa ose së paku një vit përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale.
Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.
Njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombtarisht e të lëshuar nga testatorët oficalë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A1 të CEFR, përkatësisht BULATS ose Apts; ose TOEFL PBT së paku 310 pikë, TOEFL CBT së paku 35 pikë, ose TOEFL IBT së paku 10 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përmbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrajnë dëshmitë për përmbushje të kushteve, në original ose kopje të vërtetuara në noter.

Kandidatët për të gjitha pozitën e punës, duhet të parashtrajnë dokumentet në vijim:
Dëshmi të shtetësisë;
Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit;
Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë
Dëshmi për njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
Biografi të shkurtë;
Letër motivimi.

Orari i kohës së punës:
Orë të punës në javë: 40 orë,
Koha e punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 08:30 deri në ora 16:30.
Shuma në të holla e neto pagesës bazë është 23.190,00 denarë.
Kandidatët e zgjedhur do të lidhin marrëveshje për punësim për kohë të caktuar për periudhë deri më 31.12.2017.
Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vetë ditën e publikimit). Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.
Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtrohet në arkivin e: IP Qendra ndërkomunale për punë sociale të Qytetit të Shkupit, ose përmes postës në adresën në vijim:
rr. “Nikolla Vapcarov” nr. 11 – Shkup. (me shenjë “për shpallje”)
Departamenti për punë administrative dhe menaxhim me resursat njerëzore
Kontakt telefoni: 02/3297 703
02/3297 793

Fletëparaqitjet e parashtruara pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.
IP Qendra ndërkomunale
për punë sociale e Qytetit të Shkupit
U. D. Drejtor
Suzana Ilievska – Gjorgievska

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pika 2 e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/141, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Kriva Pallankë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE 1/2017 Për punësim të 2 (dy) realizuesve për kohë të caktuar me kohëzgjatje deri më 31.07.2017 në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Kriva Pallankë

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Kriva Pallankë publikon shpallje për punësim të 2 (dy) realizuesve për kohë të caktuar për pozitën në vijim

1. Punëtor i diplomuar social.....dy (2) realizues

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Kriva Pallankë (për të gjithë kandidatët):
Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
Në mënyrë aktive të njëj gjuhën maqedonase;
Të jetë i moshës së rritur;
Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Kriva Pallankë.
- 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit (punë sociale dhe politikë sociale) dhe së paku 2 vjet përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale,
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- Njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombtarisht e të lëshuar nga testatorët oficalë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A1 të CEFR, përkatësisht BULATS ose Apts; ose TOEFL PBT së paku 310 pikë, TOEFL CBT së paku 35 pikë, ose TOEFL IBT së paku 10 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përmbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrajnë dëshmitë për përmbushje të kushteve, në original ose kopje të vërtetuara në noter.

Kandidatët për të gjitha pozitën e punës, duhet të parashtrajnë dokumentet në vijim:
-Dëshmi të shtetësisë;
-Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
-Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit.
-Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë
-Dëshmi për njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
-Biografi të shkurtë;
-Letër motivimi.

Orari i kohës së punës: orë të punës në javë: 40, koha e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 08:30 deri në ora 16:30.
Shuma në të holla e neto pagesës bazë është 23,191 denarë
Kandidatët e zgjedhur do të lidhin marrëveshje për punësim për kohë të caktuar.
Punësimi është në kohëzgjatje deri më 31.12.2017.
Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vetë ditën e publikimit). Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtrohet në arkivin e: IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Kriva Pallankë, ose përmes postës në adresën në vijim:
rr. Nikolla Tesla pn, Kriva Pallankë
Departamenti për resurse njerëzore
(me shenjë “për shpallje”) 1/2017.
Personi për kontakt Zorica Petrovska
Kontakt telefoni 075 451 037

Fletëparaqitjet e parashtruara pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IP Qendra ndërkomunale
për punë sociale Kriva Pallankë

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pika 2 e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/141, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Gostivar publikon:

SHPALLJE PUBLIKE Për punësim të një realizuesi për kohë të caktuar me kohëzgjatje deri më 31.12.2017 në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Gostivar

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Gostivar publikon shpallje për punësim të një realizuesi për kohë të caktuar për pozitën në vijim

1. Punëtor i diplomuar social– 1 (një) realizues

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Gostivar:
Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
Në mënyrë aktive të njëj gjuhën maqedonase;
Të jetë i moshës së rritur;
Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Gostivar

Për pozitën e theksuar – punëtor i diplomuar social të kenë të mbaruar arsim sipëror – fakultet të mbaruar filozofik – Instituti për punë sociale dhe politikë sociale

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përmbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrajnë dëshmitë për përmbushje të kushteve, në original ose kopje të vërtetuara në noter.

Kandidatët për të gjitha pozitën e punës, duhet të parashtrajnë dokumentet në vijim:
Dëshmi të shtetësisë;
Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit.
Biografi të shkurtë;
Letër motivimi.

Orari i kohës së punës: orë të punës në javë: 40, koha e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 08:30 deri në ora 16:30.
Shuma në të holla e neto pagesës bazë është 23,000,00 denarë
Kandidatët e zgjedhur do të lidhin marrëveshje për punësim për kohë të caktuar në kohëzgjatje deri më 31.12.2017.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vetë ditën e publikimit). Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.
Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtrohet në arkivin e: IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Gostivar, ose përmes postës në adresën në vijim: IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Gostivar, rr. “Major Çede Filipovski” nr. 19.

Personi për kontakt: Nadica Veliçkovska
Kontakt telefoni 070 345 120

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Gostivar



Liga Evropë, dy ekipet e vetme shqiptare zhvillojnë ndeshjet kthyes

Shkëndijës dhe Skënderbeut u mjafton një gol për kualifikim

Shkëndija por edhe Skënderbeu në ndeshjen e parë pësuan me rezultatin 2:1, andaj atyre do tu mjaftonte një gol për tu kualifikuar në plej-of

Shkup, 2 gusht – Futbollistët e Shkëndijës të gatshëm do të hyjnë sot për të zhvilluar ndeshjen kthyesë përballë Trakait në kuadër të raundit të tretë të eliminatoreve të UEFA "Europa League". Edhe pse me tre mungesa të mëdha, Stefan Vujčić (i lënduar) dhe Ardian Cuculi e Steni Zhuniorin, të cilët u ndëshkuan në përballjen e parë në Lituanë, kuqezinjtë besojnë se mund të përmbysin humbjen nga ndeshja e parë me 2:1 dhe të kualifikohen në plej-of dhe të përsërisin suksesin e vitit të kaluar. Cekim, djemve të trajnerit Qatip Osmani do tu mjaftonte një gol për t'ia arritur qëllimit. Ndryshe, mesfushori kumanovar Armend Alimi flet me respekt për ekipin lituanes, mirëpo beson fuqishëm në potencialin e



skuadrës së tij, që sipas tij është e denjë të përmbysë humbjen 2:1 në ndeshjen e parë me Trakain. "Vazhdojmë serinë e ndeshjeve evropiane të enjten me Trakain, por ne duam të vazhdojmë qëndrimin në UEFA 'Europa League'. Kemi rezultat aktiv nga ndeshja e parë kur arritëm të shënojmë si mysafirë, por gjithsesi humbja si humbje na detyron të jemi ne ekipi që duhet të ndjek rezultatin. Nuk do të jetë aspak e lehtë pasi edhe rivali ka planet e veta, por besoj fuqishëm se nëse ne do të jemi në nivelin tonë, në fund do të marrim rezultatin e dëshiruar për tu futur për të dytin vit me

radhë në plej-of të UEFA 'Europa League', deklaroi Alimi.

Ndryshe, edhe skuadra tjetër shqiptare Skënderbeu njësoj si Shkëndija, do të kërkojë sot kualifikimin në plej-of. Korçarët kanë negativë prej 2:1 në ndeshjen e parë që u zhvillua në Çeki përballë Mlada Boleslav dhe atyre u mjafton fitore me një gol për t'ia arritur qëllimit. I rikthyer nga dëmtimi dhe gati të vihet në shërbim të skuadrës, mbrojtësi kosovar Bajram Jashanica kërkon modesti dhe angazhim maksimal, ndërsa ka besim te grupi. "Shanset për tu kualifikuar? Shanset janë 50 me 50. Nuk duhet të har-

rojmë që me një gol e kemi kualifikimin në dorë. Por, nuk duhet të harrojmë që edhe kundërshtari ka potencialin e vet. Ne duhet të luftojmë siç bëjmë në dy ndeshjet me Kairatin. Duhet të japim gjithçka që kemi në fushë. Kemi një grup shumë të mirë dhe besoj që do t'ia dalim. Duhet të bëjmë punën më të mirë dhe të zbatojmë detyrat që na kërkon trajneri për të arritur suksesin dhe të shkojmë më lart", deklaroi për "Supersport", Jashanica.

Ndërkohë, Shkëndija – Trakai do të fillojë në ora 17.00, ndërsa ajo mes Skënderbeut dhe Mlada Boleslav në ora 20.00. (B.K.)



EHF përjashton Greqinë nga kampionati evropian

Përfaqësuesja e kadeteve të Greqisë në hendboll është përjashtuar nga kampionati i hendbollit në Shkupit. Federata Evropiane e Hendbollit vendosi që të largojë Greqinë për shkelje të rregullores, pasi hendbollistët grekë qëndruan plot 32 sekonda në terren dhe u tërhoqën në zhveshtore, pasi në tabelën zyrtare qëndronte emri Maqedo-

nia në vend të FYROM. "Është hapur hetim ndaj Federatës së Greqisë dhe sipas rregullores së EHF-së, nenit 7 nga lista e EHF, Greqia përjashtohet nga kampionati në Shkup. Ndërkohë sipas neneve 12 dhe 14.1 nga rregullorja, rezultati zyrtar është 10-0. Greqia poashtu është dënuar me 25 mijë euro", thuhet në kumtesën e EHF.

Khaka largohet nga kombëtarja e Shqipërisë?

Mesa duket ai reagoni i Taulant Xhakës nuk ka treguar asgjë, sepse siç u raportua mesfushori kuqezi nuk ka pranuar të takohet me trajnerin e ri të Kombëtares, Kristian Panuçi i cili kishte udhëtuar posaçërisht për tu takuar me Xhakën që ta bindte që te kthehej në Kombëtare. Por kjo gjë nuk ka ndodhur edhe për këtë çështje italiani ka marrë një vendim që mund të jetë mjaft i hidhur si për Xhakën ashtu edhe për tifozët. "Sport Ekspres" raporton se vendimi i Panuçit do jetë që për ndeshjet e radhës, ndaj Lihtenshtejnit dhe Maqedonisë, Taulant Xhaka nuk do të grumbullohet, por rrezikon



madje që të mbyllë vitin jashtë kombëtares, pra këto eliminatore të Botërorit 2018. Gjithsesi kjo gjë pritet të zyrtarizohet me 28 gusht, atëherë kur edhe Panuçi do të shpallë listën përfundimtare.

Agolli "hakmerret" për Kukësin

Ansi Agolli merr hak për Kukësin në raundin e tretë kualifikues të Çampionit Ligës. Karabagu ku aktivizohet mbrojtësi i kombëtares shqiptare eliminoi Sherifin e Tiraspolit, duke e mundur 1-2 skuadrën kampione të Moldavisë në fushën e saj, teksa sfida e parë e luajtur në Azerbajxhan kishte përfunduar me rrjeta të paprekura.

34-vjeçari, titullar i padiskutueshëm te Karabagu spikati si gjithmonë në krahun e majtë, madhe dha asistimin për golin e dytë që shuajt shpresat e Sherifit për një përmbysje të mundshme. Ndërkohë, Skuadra e Agollit pret të mësojë kundërshtarin në fazën plej-ofit të Çampionit, me shortin që do të hidhet më 4 gusht.



Emini dhe Kukësi në "luftë"

Shkup, 2 gusht - Rinovimet automatike të kontratave po hapin shumë probleme te Kukësi, teksa së fundmi të gjithë futbollistët që afrohen në ekip po i shohin mirë klauzolat, ndërsa me ata që mbyllën sezonin, duket se do të ketë probleme gjyqësore. Një ndër lojtarët që ka probleme është sulmuesi Izair Emini, i cili ka përsëritur se është lojtar i lirë dhe kërkon të ikë. Derisa, i lirë të largohet është edhe futbollisti tjetër nga Maqedonia, Nijaz Lena. "Unë jam lojtar i lirë, pasi kontrata e rregullt që kam firmosur me FK Kukësin më ka përfunduar me



skualifikimin në kupat e Evropës. I kam kërkuar drejtuesve të klubit që të më japin lejen e kalimit, pasi dëshiroj të largohem nga Shqipëria, sepse kam

probleme familjare. Pastaj, arsyeja tjetër është se e shoh veten diku tjetër, larg nga klubi i Kukësit", ka thënë ndër të tjera në "Panorama Sport" sul-

muesi nga Tetova. Dëshira e tij është që gjërat të mos shkojnë në instanca më të larta, siç janë UEFA dhe FIFA. "Për gjithçka çka unë kam bërë te Kukësi, nuk duhet që gjërat të shkojnë në instanca të tjera, por të zgjidhen me mirëkuptim. Personalisht i kam rezervuar të gjitha thirrjet dhe bisedat me krerët e klubit, ndërsa ata më kanë ngarkuar me një kontratë tjetër që nuk është e ligjshme dhe as e moralshme. Nëse nuk do merremi vesh me mirëkuptim, do e ankimoj çështjen në FIFA nëpërmjet zyrës juridike që kam kontraktuar, por shpresoj mos të shkojë deri aty

çështja, pasi në fund do vërtetohet kush ka të drejtë" – thotë Emini, i cili pjesë e Kukësit është që nga janari i vitit 2016-të. Ai brenda kësaj periudhe të kaluar te skuadra kampione e Shqipërisë zhvilloi plotësisht 53 ndeshje, duke realizuar edhe 18 gola. Gjithashtu ai hyri në historinë e klubit nga verilindja e Shqipërisë, duke rrëmbyer tre titujt kryesor, titullin e kampionit, Kupën si dhe Super Kupën e Shqipërisë.

Ndërkohë, përveç Izair Emini, në stërvitjen e djeshme të Kukësit munguan edhe Enea Koliçi e Nijaz Lena. Ashtu si sulmuesi, edhe portieri

me mesfushorin, kanë të njëjtat pretendime, pra konfirmojnë se nuk janë nën kontratë. Nga ana tjetër, klubi thekson se është e kundërta. Menaxheri i përgjithshëm i klubit, Naim Halili, ka saktësuar dje, në një bisedë për "Supersport", se lojtarët duhet të paraqiten në stërvitje. "Koliçi është pjesë e Kukësit dhe nën kontratë, ashtu si Emini dhe Lena. Ne i kemi njoftuar dhe nëse nuk paraqiten, atëherë do të marrim masa. Të gjithë lojtarët janë nën kontratë, veç Pejçit dhe Kariokës që janë larguar. Edhe Shameti do rinovojë", ka deklaruar Halili.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16 dhe 142/16”) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 90/15”), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16”) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/15”), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 30/2017

për punësimin e 5 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komunën e Prilepit” për vendet e punës në vijim:

- UPR 01 01 V04 000 Bashkpunëtor i ri për 1 realizues(ë)

Orari i punës :

 - Ditët e punës e hënë-e premte
 - Orët javore të punës 40
 - Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 20.942,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2017 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e përgjithshme:

 - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
 - Të jetë i moshës madhore,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.

Kushtet e posaçme:

 - niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 - Shkencat Juridike
 - me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

 - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
 - mësim dhe zhvillim
 - komunikim
 - arritje të rezultateve
 - puna me të tjerë/puna ekipore
 - ndërgjegjësim strategjik
 - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
 - menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

 - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
 - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombëtarisht e të lëshuar nga testatorët oficialë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me 3 pikë maksimum, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 400 pikë, TOEFL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.
 - Njohja e gjuhës angleze mund të dëshmohet edhe me dorëzim të certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht nga STANAG 6001 standarde të NATO-s në nivelin përkatës, ku nëpunësit administrativë nga kategoria V duhet të posedojnë certifikatë me STANAG 1+1+1+1+
- UPR 01 01 V04 000 Bashkpunëtor i ri për 1 realizues(ë)

Orari i punës :

 - Ditët e punës e hënë-e premte
 - Orët javore të punës 40
 - Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 20.942,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2017 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e përgjithshme:

 - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
 - Të jetë i moshës madhore,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.

Kushtet e posaçme:

 - niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 - Shkencat Ekonomike
 - me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

 - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
 - mësim dhe zhvillim
 - komunikim
 - arritje të rezultateve
 - puna me të tjerë/puna ekipore
 - ndërgjegjësim strategjik
 - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
 - menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

 - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
 - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombëtarisht e të lëshuar nga testatorët oficialë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me 3 pikë maksimum, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 400 pikë, TOEFL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.
 - Njohja e gjuhës angleze mund të dëshmohet edhe me dorëzim të certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht nga STANAG 6001 standarde të NATO-s në nivelin përkatës, ku nëpunësit administrativë nga kategoria V duhet të posedojnë certifikatë me STANAG 1+1+1+1+
- UPR 01 01 V04 000 Bashkpunëtor i ri për 1 realizues(ë)

Orari i punës :

 - Ditët e punës e hënë-e premte
 - Orët javore të punës 40
 - Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 20.942,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2017 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e përgjithshme:

 - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
 - Të jetë i moshës madhore,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.

Kushtet e posaçme:

 - niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 - Shkencat Juridike, Administratë publike ose Arsimit
 - me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

 - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
 - mësim dhe zhvillim
 - komunikim
 - arritje të rezultateve
 - puna me të tjerë/puna ekipore
 - ndërgjegjësim strategjik
 - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
 - menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

 - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
 - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombëtarisht e të lëshuar nga testatorët oficialë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me 3 pikë maksimum, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 400 pikë, TOEFL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.
 - Njohja e gjuhës angleze mund të dëshmohet edhe me dorëzim të certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht nga STANAG 6001 standarde të NATO-s në nivelin përkatës, ku nëpunësit administrativë nga kategoria V duhet të posedojnë certifikatë me STANAG 1+1+1+1+
- UPR 01 01 V04 000 Bashkpunëtor i ri për 1 realizues(ë)

Orari i punës :

 - Ditët e punës e hënë-e premte
 - Orët javore të punës 40
 - Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 24.972,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2017 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Faza e 4 – të: Testi i personalitetit realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të fazës së 3 – të.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, nenit 22 paragrafi 1 alineja 2 dhe paragrafi 8 i Ligjit për të punësuarit në sektorin publik, Vendimit për nevojën për punëtor nr. 04-572/1 të datës 31.07.2017, nenit 34 të Statutit të NP Komunalec Kavadar ndërsa në pajtim me Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës, UD Drejtori i ndërmarrjes

Publikon SHPALLJE Për pranin të punëtorëve

I. NP Komunalec – Kavadar ka nevojë për pranin të punëtorëve për kohë të caktuar për 9 (nëntë) muaj edhe atë për vendet e punës në vijim:

1. Punëtor i përgjithshëm në Departamentin për rrjetin urban dhe rural të ujësjellësit Sektori ujësjellës dhe kanalizim 4 (katër) realizues me shifër të vendit të punës KDR 03 05 B02 031 kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune të kenë të mbaruar arsimin fillor, me ose pa përvojë pune.

Orari i punës së kandidatit të zgjedhur do të jetë prej ora 07 deri në ora 15 prej ditës së hënë deri ditën e premte ose 40 orë në javë, shumën në të holla e neto pagesës themelore është 13.500,00 denarë.

2. Sigurim të pronës dhe personave 1 (një) realizues me shifër të vendit të punës KDR 04 02 A01 002 kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune të kenë të mbaruar arsimin e mesëm dhe licencë për sigurim të pronës dhe personave, me ose pa përvojë pune.

Orari i punës së kandidatit të zgjedhur do të jetë me nga 8 (tetë) orë ose 40 orë në javë, shumën në të holla e neto pagesës themelore është 16.500,00 denarë.

Shpallja është e hapur 5 (pesë) ditë pune duke llogaritur nga dita e publikimit.

Kandidatët krahas lutjes për punë të parashtrajnë edhe dëshmi për arsimin e mbaruar dhe për kushtet e posaçme për vendin e punës.

Lutjet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Zgjedhja do të realizohet në pajtim me nenin 23 paragrafi 2 i Ligjit për marrëdhënie pune gjegjësisht nëse në shpalljen publike janë paraqitur deri në 200 kandidatë për një vend pune zgjedhja e kandidatëve bëhet në afat prej 60 ditë, prej 201 deri në 500 kandidatë prej 90 ditë, mbi 500 kandidatë prej 120 ditë, pas kalimit të afatit për paraqitje.

Fletëparaqitja me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet në arkivin e NP Komunalec – Kavadar, rr. "Industriska" pn.

NP Komunalec – Kavadar UD Drejtori /Jurist i diplomuar I. Atanasov/

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pika 2 e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/141, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), IP Qendra ndërkommunale për punë sociale Radovish publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësimin të 2 (dy) realizuesve për kohë të caktuar me kohëzgjatje deri më 31.07.2017 në IP Qendra ndërkommunale për punë sociale Radovish

IP Qendra ndërkommunale për punë sociale Radovish publikon shpallje për punësimin të 2 (dy) realizuesve për kohë të caktuar për pozitën në vijim:

- 1. Punëtor i diplomuar social – 1 (një) realizues
2. Pedagog – 1 (një) realizues

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkommunale për punë sociale Radovish (për të gjithë kandidatët):

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
Në mënyrë aktive të njëjshme maqedonase;
Të jetë i moshës së rritur;

Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shquptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës. Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkommunale për punë sociale Radovish

Për vendin e punës me numër rendor 1 (një) dhe për vendin e punës me numër rendor 2 (dy)

1. Kushtet e posaçme të përcaktuara me Ligjin për mbrojtje sociale për dëhësit e shërbimeve në sferën e mbrojtjes sociale nga kategoria A – profesionale janë:

- Kualifikimet profesionale dhe përvoja e punës edhe atë:
o Për nivelin A2 të arritura 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit dhe së paku tre vjet përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale,
o Për nivelin A5 të arritura 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit dhe së paku dy vjet përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale,
o Për nivelin A6 të arritura 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të arsimit dhe pa ose së paku një vit përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale.
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë,

-Njohje aktive të njëjshme me të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombëtarisht e të lëshuar nga testatorët oficialë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A1 të CEFR, përkatësisht BULATS ose Apts; ose TOEFL PBT së paku 310 pikë, TOEFL CBT së paku 35 pikë, ose TOEFL IBT së paku 10 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Geta.

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përmbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrajnë dëshmitë për përmbushje të kushteve, në original ose kopje të vërtetuar në noter.

Kandidatët për të gjitha pozitat e punës, duhet të parashtrajnë dokumentet në vijim:

- Dëshmi të shtetësisë;
Dëshmi se nuk i është shquptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit;
Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë
Dëshmi për njohje aktive të njëjshme me të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht); (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME NË PAJTIM ME SISTEMATIZIMIN);
Biografi të shkurtë;
Letër motivimi.
Orari i kohës së punës: orë të punës në javë: 40, koha e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

Shuma në të holla e neto pagesës bazë është 23.181,00 denarë.

Kandidatët e zgjedhur do të lidhin marrëveshje për punësimin për kohë të caktuar.

Punësimi është në kohëzgjatje deri më 31.12.2017.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vetë ditën e publikimit). Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtrohet në arkivin e: IP Qendra ndërkommunale për punë sociale Radovish, ose përmes postës në adresën në vijim:

rr. 22 Oktomvri nr. pn, Radovish
Departamenti për resurse njerëzore
(me shenjë "për shpallje")
Personi për kontakt Dragi Dimitriev
Kontakt telefoni 077/980-338

Fletëparaqitjet e parashtruar pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IP Qendra ndërkommunale për punë sociale Radovish U, D Drejtor Dragi Dimitriev

Advertisement for 'CENTAR ZA GUMI' featuring tires, a 30% discount, and contact info for Kavadar.

Advertisement for 'URGJENTISHT' regarding property for sale in Serava-Shkup with contact details.

Advertisement for 'URGJENTISHT' regarding property for sale in Kavadar with contact details.

Advertisement for 'Marketing' services at 'Koha' newspaper, including contact info and website links.

Advertisement for 'Organizata Humanitare "Ogranok na MIHO"' regarding vehicle repairs and services in Tetovë.

Text regarding job opportunities and organizational information, mentioning 'Koha' and various job postings.

Section titled 'KONKURS' regarding a competition for job positions in the 'Shën Kirili dhe Metodi' institution.

Detailed information regarding the 'KONKURS' process, including application procedures and contact details for the organizing institution.



Someone na ka përmirësuar si grup dhe si individë. Unë mendoj se ai është shumë i lumtur në klubin tonë dhe do të qëndrojë për shumë vite të tjera

Sipas "International Journal of Computer Science in Sport"

Lionel Messi, ylli më i paguar i futbollit në botë

Ky talent i mrekullueshëm është kompensuar rregullisht me një paketë pagash, që e bëjnë Messin një nga njerëzit më të pasur në sport, së bashku me kundërshtarin e Real Madridit, Cristiano Ronaldo



Argentinasi ka fituar pesë herë "Topin e Artë", një rekord i paparë, që nga debutimi i tij në "Camp Nou", duke ndihmuar Barcelonën në një dekadë suksesi të shkëlqyeshëm. Ky talent i mrekullueshëm është kompensuar rregullisht me një paketë pagash, që e bëjnë Messin një nga njerëzit më të pasur në sport, së bashku me kundërshtarin e Real Madridit, Cristiano Ronaldo. Megjithatë, sipas "International Journal of Computer Science in Sport", ai nuk mund të meritojë një vlerësim kaq të lartë. "IJCSS" përpiloi të dhënat e pagave dhe analizën e performancës nga ligat më të larta të Evropës në studimin e tij,

duke zgjedhur vitin 2016 si një vit bazë. Variablat e tilla si mosha, pozicioni, klubi dhe një mori e tërë vlerësimesh tëtributeve në fushat kyçe u mblodhën dhe u zhvilluan nëpërmjet një algoritmi të dizajnuar për të përcaktuar vlerën reale të secilit lojtar. Dhe pavarësisht statusit të tij, si një nga lojtarët më të mirë në botë, Messi del në krye të listës së yjeve të paguar, me "IJCSS" që pretendon se

vlera e tij e vërtetë është rreth 320,000 € më e ulët se paga aktuale. "Është e qartë se paga e një lojtari futbollit është prekur nga faktorë të shumtë, që nuk lidhen drejtpërdrejt me punën apo aftësitë. Për shembull, një lojtar i pëlqyer nga tifozët mund të ketë kompensim më të lartë për të pasqyruar shitjet e mallrave dhe bileteve", - nënvizon raporti. - Për shembull, një lojtar i tillë si Lionel Messi merr

një pagë javore prej 550,000 €, duke qenë se ajo pjesë e saj është sponsorizimi, shitja e mallrave, të drejtat e imazhit dhe të ardhurat e tjera jashtë fushës së fitimeve, ose performancës në fushë. Duke përdorur njohjen e modelit, paga e parashikuar e Messit, e llogaritur në bazë të performancës dhe pagave të lojtarëve aktualë të futbollit në ligat kryesore, do të ishte rreth 50 për qind më

Lojtari	Paga aktuale (në €, 2016)	Paga e parashikuar
Lionel Messi	550,000	243,333
Angel Di Maria	230,000	58,974
Robin Van Persie	210,000	61,428
Ivan Rakitic	180,000	61,556
Nicolas Otamendi	180,000	61,556
Edin Dzeko	165,000	53,873
Philippe Coutinho	170,000	60,552
Isco	170,000	60,552
David Luiz	170,000	61,599
Sergio Busquets	220,000	115,342

Lojtari	Paga aktuale (në €, 2016)	Paga e parashikuar
Bernardo Silva	10,000	119,907
Harry Kane	15,000	119,798
Granit Xhaka	70,000	171,176
Timo Horn	25,000	119,581
Francisco Alcaacer	80,000	170,588
Gelson Dany Batalha Martins	30,000	119,472
Renato Sanches	35,000	119,364
Paul Nardi	25,000	104,548
Andrea Pirlo	50,000	129,500
Lavyin Kurzawa	50,000	119,038

pak, megjithëse sipas metodës ai do të ishte akoma lojtari më i paguar në botë". Argentinasi Angel Di Maria dhe ish-ylli i Arsenalit e Gallatasaraj, Robin van Persi, kompletojnë podiumin. Anasjelltas, Harry Kane dhe Bernardo Silva shfaqen si

lojtarët më të paguar në listën e IJCSS. Kane, sigurisht që ka nënshkruar një kontratë të re fitimprurëse me Tottenham, ndërsa Bernardo Silva do të luajë te Manchester Siti në sezonin e ardhshëm, pas përfundimit të një lëvizjeje nga Monako.



Torres: Jemi me fat që kemi një trajner si Simeone

Fernando Torres beson se Diego Simeone do të qëndrojë për një kohë të gjatë te Atletico Madrid, pavarësisht se sipas kërkesës së bërë prej vetë atij ka shkurtuar në vetëm një sezon kontratën me klubin spanjoll. Simeone gëzon respektin e madh të futbollistëve të Atletico dhe kjo duket edhe nga fjalët e qendërsulmuesit me përvojë, Fernando Torres. "Simeone na ka përmirësuar si grup dhe si individë. Unë mendoj se ai është shumë i lumtur në klubin tonë dhe do të qëndrojë për shumë vite të tjera", tha Torres. 47-vjeçari kishte një marrëveshje deri në vitin 2020 me Atletico, por palët ranë dakord për reduktimin e kontratës deri në qershor 2018. Gjithsesi, Torres beson se bashkëpunimi do të vazhdojë edhe më gjatë. "Të gjithë e dinë atë që Diego Simeone i jep skuadrës tonë, të gjithë. Ai është shumë i aftë në komunikimin me ne dhe shpjegimin e taktikës. Jemi me fat që e kemi." - tha Torres. Më pas Torres vazhdoi: "Simeone na ka përmirësuar si grup dhe si individë. Unë mendoj se ai është shumë i lumtur në klubin tonë dhe do të qëndrojë për shumë vite të tjera. Kjo i pëlqen futbollistëve. Lojtarët tanë më të mirë kanë qëndruar në ekip sepse besojnë te Simeone. Edhe ai është aq i zgjuar sa të kuptojë se te Atletico i ka të gjitha mundësitë për të qenë i suksesshëm. Uroj të punojmë sa më gjatë me të", përfundoi Torres.

Poketino: Morata më refuzoi, se kishte frikë nga Kin

Ndodh shumë rrallë që trajnerët të zbulojnë ndonjë prapaskenë të merkatos dhe, kur e bën një mjeshtër si Maurizio Poketino, kjo kthehet automatikisht në "bombë". Trajneri i Tottenhamit, duke veshur kostumin e gazetarit, ka rrëfyer se Alvaro Morata sot do të ishte në "White Hart Lane", nëse nuk do të kishte frikë nga Harry Kin. Po, pikërisht kështu. Sipas argjentinasi, ish-sulmuesi i Real Madridit, tashmë i transferuar te Çellsit, ka pasur mundësinë të bëhej pjesë e skuadrës së tij, por ka menduar se anglezi nuk do t'i



linte kurrë vend për të qenë titullar. "Morata ka folur për mua në medie duke thënë se i kam telefonuar. Kjo ka

ndodhur që para dy vitesh apo më shumë. Kur folëm, ai më tha: 'Pse më do, kur ke një si Harri Kin?'. E dini? Nëse përiqem të blej një sulmues, të gjithë thonë: 'Për çfarë më do? Që të rri në stol? Sepse aty është Harry Kin'. Është shumë e vështirë të bindësh lojtarët e mirë të vijnë dhe pastaj të ulen në stol. Aty nis problemi", - është shprehur Poketino. Kane sezonin e kaluar u shpall golashënuesi më i mirë në Premier Ligë, me 29 gola të shënuar. Të gjithë do ta donin në skuadër, por ai është një lojtar pa çmim...

Interi ofron Zhoa Marion për Drakslerin

Interi mendon për gjëra të mëdha. Sipas "Corriere dello Sport", zikaltërve u ka lindur ideja për të sjellë Julian Draxler në Milano. Angazhimi i shtrenjtë, i pashmangshëm, Neymar te PSZH mund të kufizojë hapësirën në dispozicion për ndërkombëtarin gjerman. Interi është duke numëruar mbipopullimin e linjës përpara te parisienët në mënyrë që të nisë sulmin. Dhe, për ta bërë atë sa më efektive të jetë e mundur, ka menduar përfshirjen e Zhoa Mario në marrëveshje. Një element tashmë i afruar prej disa kohësh për PSZH. Propozimi i Interit do të jetë si më poshtë: një shkëmbim i barabartë mes Draxler dhe portugezit. Nëse francezët do të kenë interes konkret për Zhoa Mario, atëherë mund të fillojnë që tani negociatat e vërteta, të vendosura mbi këtë bazë. Draxler mund të luajë ose si një mesfushor sulmues qendror, ose si anësor i majtë, dhe pastaj mund të jetë zëvendësues i Perisic nëse Manchester Junajtedi do të kthehet e të kërkojë kroatin, duke vënë në pjetë 55



milionë euro të kërkuara nga Interi. Marrëveshja për Draxler, megjithatë, është shumë e vështirë, duke pasur parasysh moshën (24 vjeç) dhe vlerën e lojtarit. Në aspektin e mbrojtjes, më në fund "Tuttosport" raporton interesin e Interit për



Andreas Kristensen. Danez 21-vjeçar, i cili vjen nga një huazim i mirë dyvjeçar te Borussia Mönchengladbach, është kthyer te Çellsit, ku, megjithatë, është mjaft larg titullarit, pas David Luiz, Kejhil dhe Rudiger.

DASHI (20/III-20/IV)



Do të ndjeni nevojën që t'i kundërshtoni rregullat e skalitura, sidomos nëse ato pengojnë lirinë e sjelljes dhe mendimit tuaj. Do të takoheni me njerëz ekscentrik të cilët do të tërheqin vëmendjen e rrethit me qëndrimet dhe idetë e tyre. Disa provokime të imëta do t'iu argëtojnë.

DEMI (21/IV-20/V)



Dëshira për ëmbëlsira do të shtohet, e disa nga ju do të përpiqen që më ëmbëlsira apo akullore ta shuajnë urinë. Mund të dëshpëroheni në partnerin tuaj shkaku i anashkalimit të tij të obligimeve familjare dhe arsytimit gjithnjë të njëjtë. Do t'iu kaplojë dyshimi dhe xhelozia.

BINJAKËT (21/V-20/VI)



Do të hasni në persona shumë kërkuar qëndrimi i të cilëve do t'iu bëjë nervoz dhe të zgjojë inatin. Nëse po kryeni ndonjë punë sezonale, mundim i vërtetë do t'iu duket t'i buzëqeshni dikujt që s'e ka merituar. Biseda me miqtë do të duket si terapi.

GAFORRIA (21/VI-22/VII)



Do të mendoheni mes arsyeje dhe ndjenjave. E dini se atë që po e bëni nuk është e mirë, por s'do të mund të anashkaloni zërin e zemrës. Do të mblihdni forcë dhe guxim dhe do t'iu drejtoheni me porosi apo do t'i afroheni personit që iu është futur në kokë.

LUANI (23/VII-22/VIII)



Ju presin keqkuptime në rrethin e punës shkaku i qasjes tjetër për plotësimin e obligimeve të punës. Do të përgatiteni për udhëtim andaj do të shkoni pak më herët nga puna, por shkaku i panikut dhe ngutisë mundeni të harroni diçka. Përpiquni t'iu ikni keqkuptimeve familjare.

VIRGJËRËSHA (23/VIII-22/IX)



Nën efektin e disa thashethemeve dhe disponimit të keq por kalues do të filloni të shikoni më ndryshe në lidhjen tuaj të dashurisë. Do të akuzoni partnerin se po iu anashkalon e vetën do ta përjetoni si viktimën dhe planin e dytë. Një darkë intime do t'iu ndihmojë të rregulloni përshtypjet dhe brengat në zemër.

PESHORJA (23/IX-22/X)



Në orët e hershme të mëngjesit do të jeni mjaft dembelë dhe inert, e do të ankoheni edhe në shtypje të ulët apo kokëdhimbje. Adrenalinën do t'ua shtojnë miqtë që po përpiqen të organizojnë një aheng special, si dhe njerëzit që do të tregojnë se me dëshirë do të lëshoheshin me ju në një aventurë verore.

AKREPI (22/X-21/XII)



Mund të ndodhin mashtrime, intriga, grindje me të afërmit dhe prishje të ndryshme. Nëse jeni në lidhje do të ndeheni të braktisur dhe të padashur. Do të hulumtoni nëpër gjërat e partnerit tuaj për të gjetur ndonjë material komprometues. Mbështetuni në intuite.

SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



Dita është e përshatshme për shoqëri, njohje të reja dhe takime me miqtë të cilët nuk i keni parë kaherë. Shumë vëmendje do t'i kushtoni pamjes së jashtme e nëse përcaktoheni për ndryshim të frizures, nuk do të pendoheni. Do t'iu argëtojë shkuarja për blerje sidomos nëse jeni në shoqërimin e miqve.

BRICJAPI (22/XII-20/I)



Përqendrohuni në zgjidhjen e problemeve afariste dhe financiare. Nëse disa kolegë të veçantë janë në pushim, juve do t'iu jepet rasti që të merrni punët e tyre në duar tuaja dhe të tregoni se mundeni t'i kryeni pa probleme. Ambiciet dhe këmbëngulja do të shpaguhen.

UJORI (20/I-19/II)



Do t'iu bien ndërmend disa ide origjinale dhe të pazakonta që nuk do t'i pëlqejnë shumë bashkëpunëtorëve tuaj apo familjarëve. Disponimi do të jetë mjaft i ndryshueshëm, ndërsa emocionet të ekzagjeruara andaj dikush fare pa dashje mund t'iu lëndojë.

PESHQIT (20/II-19/III)



Përpëlitet në dashuri do t'iu pushtojnë më shumë se ato në punë. Bëhuni të matur në paraqitjen e ndjenjave sepse destabilizimi i vetëkontrollit mund t'iu sjellë në pozitë të papërshtatshme. Disa nga ju do të afrohen me një të huaj dhe të kaloni natë të paharrueshme. Imagjinata do të punojë pa ndalë.



KOHA	FUTBOLLISTI KOSOVAR NE FOTO	BISEDOLJ, FOL KLUBI HOLLANDEZ I FUTBOLLISTIT NE FOTO	F	ARTI QË NIXT DËSHIRËN SEKSUALE	SQIFURI	ORGANIZATA E INTELIGJENCES TALLANT XHAKA	AMERICIUMI FUTBOLLISTI SLOVEN, ZAJC	SPANIA BANOR I VJETËR, VENDES
VENDLINDJAE FUTBOLLISTIT NE FOTO (FINLANDE)								
TOKË E PAMBEJELLË					AKTORJA ANGLEZE, ANDERSON			
MERR DITURI						FUTBOLLISTI UKRAINAS, BOHDAN		
RAMON LLULL			KARROCA ME KUJAJ APO QË					AKTORJA BRAZILIANE, SONIA
SHIMANGIE MUESHTERORE (SH. PASHQ.)			LËNDA E PARË PER PRODHIMIN E ÇOKOLLATES				LUMË NE RUSI DALLGA	
DYSHKRONJËSH KARAKTERISTIK I GJUHËS SONIE		SHKENCËTARJA JAPONEZE, TOMOKO					VINEETH KUMAR RAMASAMY LUJAJ	
QYTET NE ITALI		AKTORJA AMERIKANE, SHARIS						
P							SËPATË MARANGOZI, ÇAKORRJA	
KËNGËTARJA ITALIANE, ZADORA				SPECIALISTE E MUEKIMIT TË TUMOREVE				
IDHULL				LITRI				
					KËNGËTARJA JONE, BERISHA			

Mensur Mamuti	SPECIALISTE E SEMUNDJEVE TE ZEMRES	POLITIKANI YNË, IRFAN	NËNGAKLUBET FINLANDEZE TE FUTBOLLISTIT NE FOTO	PROVË VËRTETUESË
GAZETA JONE				
KËNGËTAR AMERIKAN I HIP-HOPI, EDDIE CASTELLANOS				
SHKALLË, RADHE				
NDAIFOLIE, NDOKUND				
VEND TURISTIK AFER VLORES				

ZGJIDHJET: KOHA, ADOR, RANG, DIKU, F, OI, AM, LILESTROM, E, UGAR, XHILLIAN, MËSON, KOHUT, RIL, TALUGAT, ESKIVIME, OB, XH, AKAMI, VKR, PESKARA, LATA, PIA, ONKOLOG, IDOL, ERZANA.

Sudoku

shumë i lehtë

shumë i vështirë

	8	1				7	9			1		7				6		
6	7					9		1	5			6		4	5	8	3	
2				7					4		5	3						
3				2	6				7		6				7		3	
	5								4		7			8			4	
			3	4						2			3				5	
9				5					8		1					3	9	
5	3		6					7	2		4	3		5	7		2	
	2	6						4	5							1		4

Shumë i lehtë: 481265793, 673489215, 295173864, 349526187, 152897346, 867341529, 914752638, 538614972, 726938451. Shumë i vështirë: 184723965, 726945831, 953618472, 869457123, 375182649, 241396758, 512864397, 438579216, 697231584.

Amazon fillon shitjen e ilaçeve online

Gjiganti Amazon shumë shpejtë do të jetë pjesë e tregut farmaceutik multi-miliardësh në SHBA. Një veprim i tillë mund të nënkuptoj që tregtaret me pakicë mund të shesin ilaçet me përshkrim direkt konsumatorëve. Është bërë e ditur që Amazon ka punësuar një ekip të madh për të hyrë në këtë sektor. Sipas raportimeve të CNBC kjo kompani mund të marrë rreth 50 miliardë dollarë të tregut të shitjes së ilaçeve me përshkrim. Amazon tashmë për disa kohe bën shitjen e pajisjeve mjekësore në disa shtete në SHBA.



Konsumimi i tepërt e alkoolit do të vrasë 63 mijë persona

Përdorimi i tepërt i alkoolit do të shkaktojë deri në 62 mijë e 905 vdekje mes viteve 2017 dhe 2022, në Angli. Prej tyre, 32 mijë e 475 persona do të vdesin nga kanceri në mëlçi ndërsa 22 mijë e 519 të tjerë do të vdesin nga sëmundjet e mëlçisë. Prandaj, mjekët po kërkojnë nga qeveria, vënie e një çmimi prej 50 paund për litër që do të shpëtonte 1 mijë e 150 jetë në pesë vjet. Gjithashtu, kjo do t'ia shpëtonte



NHS-së 326 milionë funte dhe t'i ulte kostot e krimin për 711 milionë funte më shumë. Preventiva është thelbësore pasi që diagnostat në spitale kërkojnë terapi të shtrenjta dhe të limituara. Hulumtimi erdhi nga Universiteti i Sheffield që zbuloi se përdorimi i keq i alkoolit do t'i kushtojë 16.74 miliardë funte NHS-së. Sipas Fondacionit për Hulumtim të Mëlçisë, mosveprimi nga qeveria po çon në humbjet e evitueshme të jetëve.

Shpejtësia po vret njëjtë sikurse alkooli

Një studim i ri i kryer në SHBA tregon se në periudhën nga viti 2005 deri në 2014, numri i të vdekurve nga shpejtësia dhe alkooli ishte pothuajse i barabartë. Gjatë kësaj periudhe, në komunikacionin rrugor amerikan kanë vdekur 112.580 në aksidentet të cilat janë shkaktuar nga tejkalimi i shpejtësisë së kufizuar, ndërsa në aksidentet për shkak të alkoolit të vdekur kanë mbetur 112.948 persona, transmeton Koha.net.



Këtë studim e ka bërë Bordi Kombëtar i Sigurisë së Transportit në SHBA (NTSB - National Transportation Safety Board), i cili, duke komentuar rezultatet, u ka bërë thirrje organeve kompetente që të marrin masa për kontrollimin e tejkalimit të kufizimit të shpejtë-

sisë dhe kontrollimin e nivelit të alkoolit në gjakun e drejtuesve të automjeteve. Fatkeqësisht, aksidentet e shumta me fatalitet nga

arsyet e njëjta (tejkalim i shpejtësisë dhe alkooli) kanë ndodhur dhe po ndodhin edhe në vendin tonë.

Shkencëtarët rus e kthejnë qymyrin në ar!

Një eksperiment në zona të thella të Rusisë, mund të ndryshojë historinë e metalit aq të lakmueshëm nga të gjithë: ari. Shkencëtarët e qendrës shkencore në Amur, të Akademisë ruse të shkencave, repartit i Lindjes së largët, kanë gjetur mënyrën sesi të përfitojnë deri në 1gr ar nga çdo tonelatë e qymyrit të përdorur. Pajisjet eksperimentale ekzistojnë dhe është planifikuar që të vendosen në njërin prej furrave këtë vit. Prej 15



vjetësh shkencëtarët rusë analizojnë përbërjen e qymyrit nga vendet e ndryshme të rajonit, dhe ata thonë se çdo tonelatë e qymyrit të basenit të

Jerkovecit, përmban rreth 1 gram ar. Pajisja e përfitimt të arit nga qymyri, funksionon në këtë mënyrë: tymi nga qymyri i përdorur kalon nëpër një sistem shumë shkallor të pastrimit. Primesat më parë pastrohen, e më pas kapen nga filtri, nga ta nxirret koncentrat i arit, që më pas i nënshtrohet rafinimit. Rezervat e qymyrit në gjithë planetin janë gjigante. Edhe vendi ynë është shumë i pasur me këtë mineral të dalë "jashtë mode".

KALENDARI HISTORIK 3 GUSHT

8 - Gjenerali i Perandorisë Romake, Tiberi mund Dalmatët tek Lumi Batina.
435 - Patriarku i shkarkuar i Konstantinopojës, Nestori, që konsiderohet themelues i Nestorianizmit dëbohet nga Perandori bizantin Teodori II në një manastir në Egjipt.
881 - Beteja e Saukortit: Mbreti i Francës, Luigji III mund Vikingët.
1108 - Kurorëzohet si Mbret i Francës, Luigji VI, "I trashit".
1492 - Të gjithë hebrenjtë dëbohet nga Spanja.
1914 - Flota franceze lundron për në Afrikën Veriore.
1914 - Turqia nënshkruan pakt ushtarak me Gjermaninë.
1940 - Trupat italiane pushtojnë Somalinë britanike.
1944 - Në kampin e përqendrimit Auschwitz-Birkenau mbyten me gaz 4,000 jevgj.
2004 - Rihapet piedestali i Statujës së Lirisë pas mbylljes së saj që nga 11 shtatori i vitit 2001.

A E DINI SE...



Një njeri mund të jetojë pa ushqim për më shumë se tri javë, por uji është një muhabet tjetër. Të paktën 60% e trupit të një të rrituri përmban ujë, dhe çdo qelizë e gjallë në trup ka nevojë për ujë që të vazhdojë funksionimin. Uji vepron si një lubrifikant për nyje, rregullon temperaturën e trupit tonë përmes djersitjes dhe frymëmarrjes, dhe çka jo tjetër. Ndryshe nga ushqimi, koha maksimale që një person mund të mbijetojë pa ujë duket se është vetëm një javë.



BARSOLETA



FARMACISTI DHE DJALOSHI

Një i ri hyn në barnatore dhe i thotë farmacistit:
- Më jepni një prezervativ se e dashura më ka ftuar sonte për darkë në shtëpinë e saj dhe mendoj se kërkon më shumë nga unë. Pasi e merr prezervativin, i riu kthehet prapë:
- Më jepni edhe një ju lutem, se motra e të dashurës sime më sheh me një sy që mendoj se kërkon diçka.
Farmacisti ia jep prezervativin e dytë, ndërsa djaloshi shkon deri te dera dhe kthehet sërisht.
- Edhe një ju lutem, se nëna e të dashurës sime është grua shumë e bukur dhe shpesh më provokon, prandaj të jem i përgatitur për çdo rast.
Gjatë darkës, i riu dhe e dashura e tij ulen në njërin anë të tavolinës, ndërsa motra dhe nëna e të dashurës ulen përballë tyre. Më pas vjen babai i vajzës, ndërsa djaloshi ul kokën dhe fillon lutjen:
- Falënderimi i takon Zotit që na ka dhënë për të ngrënë dhe për të pirë...
Kalojnë 10, 20, 30 minuta ai nuk e ndërpret lutjen.
- Nuk e kam ditur se je kaq fetar - i thotë e dashura.
- As unë nuk e kam ditur se e ke babanë farmacist - ia kthen djaloshi.

THËNIA E DITËS

Duhet të mësosh si të përzgjedhësh mendimet, ashtu si përzgjedh rrobat çdo ditë. Kjo është një fuqi që mund ta kultivoni. (Elizabeth Gilbert)

